

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7063
E mërkurë, 6 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Këshilli i BE-së do t'i
kërkojë Kosovës të bëjë
më shumë për heqjen
e masave



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA PËSON RËNIE NË TESTIMIN E PISA-S

'REZULTATI I PISA-S, KATASTROFË ARSIMORE. ANALFABETIZMI NË KOSOVË, NË RITJE'



Rezultatet e publikuara të testit PISA për vitin 2022 tregojnë se Kosova ka shënuar regres në fushën e arsimit, madje situata është edhe më e rëndë seç ka qenë në vitin 2018, kur ka qenë hera e fundit kur ka pasur matje. Kosova ka zënë vendin e 78

nga 80 shtete pjesëmarrëse, pra ka rënie nga viti 2018 për 11 pikë. Vendi ka zënë pozitën e 76 për lexim, në pozitën e 77 për shkencë si dhe në pozitën e 74 për matematikë. Ministrija e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se pandemia e

koronavirusit ka ndikuar në këtë rezultat. Ndërkaq përfaqësuesit e partive opozitare dhe shoqëria civile kanë thënë se ky rezultat është një katastrofë arsimore, duke theksuar se analfabetizmi në Kosovë është në rritje

KURTI: SISTEMI I DREJTËSISË TË JAPË DËNIME MERITORE PËR DHUNUESIT DHE PËR KRIMINELËT F. 7



SHTËPIA E BARDHË PARALAJMËRON FITORE TË PUTINIT NËSE NDALET NDIHMA PËR UKRAINËN F. 2



OPINION

BACA ADEM DEMAÇI DHE ADEM JASHARI, TË PADËSHIRUAR NË PRISHTINË!

F. 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



GJYKATAT "NUK E ZBATUAN UDHËZUESIN" NË DËNIMET PËR TERRORIZËM F. 5

NIS IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UP-SË DHE RTK-SË F. 6

EKONOMI



AMBASADA AMERIKANE: MBËSHËTETIM TRANZICIONIN AMBICIOZ ENERGETIK NË KOSOVË F. 7

FRANCA RRIË NIVELIN E RREZIKUT NGA GRIPI I SHPEZËVE F. 7

SPORT



KUALIFIKOHEN LLAPI DHE MALISHEVA F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli thotë se pret fazë të re të vështirë në Gazë

JERUSALEM, 5 DHJETOR - Izraeli pret luftime të vështira në fazën e re të luftës së tij në Gazë, por është i hapur për "këshilla konstruktive" për reduktimin e dëmeve ndaj civilëve, për aq kohë sa sugjerimet janë në përputhje me objektivin e tij për shkatërrimin e grupit radikal palestinez, Hamas - i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, ka thënë një zëdhënës i qeverisë izraelite të martën. "Ne po vazhdojmë fazën e dytë tani. Një fazë e dytë që do të jetë e vështirë ushtarakisht", u ka thënë gazetarëve zëdhënësi Eylon Levy, raporton "Reuters".

Forcat izraelite kanë nisur të vepronë në zonën jugore të Rripit të Gazës, ku popullsia është rritur për rreth 1 milion refugjatë nga zonat veriore, ndërsa Izraeli është përballur me trysni të madhe ndërkombëtare, përfshirë nga Uashingtoni, për t'i kufizuar

viktimat civile. "Ne sigurisht do t'i përmendim këshillat konstruktive që do t'i marrim, këshillat serioze për strategji ushtarake për mënyrën e shënjim të Hamasit, duke minimizuar dëmet ndaj civilëve", ka thënë Levy.

Por, ai ka shtuar se këshillat duhet të jenë në përputhje me objektivin e Izraelit për shkatërrimin e grupit ekstremist palestinez. "Ne do ta vazhdojmë fushatën tonë për shkatërrimin e Hamasit... Shtetet e Bashkuara janë të pajtimit të plotë me ne sa iu përket objektivave strategjike të kësaj lufte dhe se kjo luftë nuk mund të përfundojë me një Hamas ende aktiv", ka thënë ai.

Levy ka shtuar se Izraeli po bën shumë përpjekje për t'i shkurtuar dëmet ndaj civilëve. "Ne nuk e kemi zgjedhur fushëbetëjen, Hamasi e ka zgjedhur atë", është shprehur ai.

Hamasi ka nxitur luftë me Izraelin



duke kryer sulme vdekjeprurëse në jug të Izraelit, më 7 tetor, gjatë të cilave luftëtarët e grupit palestinez vranë afër 1 200 persona dhe marrë peng 240 të tjerë. Që atëherë nga sulmet izraelite në

Gazë janë vrarë mbi 15 000 palestinezë - pothuajse dy e treta e viktimizeve janë gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazën e kontrolluar nga Hamasi.

Mbi tri e katërta e popullsisë së këtij territori janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre për shkak të bombardimeve dhe sulmeve tokësore të Izraelit, që krijuan një krizë humanitare.

Shtëpia e Bardhë paralajmëron fitore të Putinit nëse ndalet ndihma për Ukrainën



UASHINGTON, 5 DHJETOR - Shtëpia e Bardhë e ka lëshuar një paralajmërim të hënën se fondet e planifikuara për Ukrainën do të përfundojnë në fund të vitit dhe që presidenti rus Vladimir Putin mund ta fitojë luftën nëse

Kongresi nuk miraton fonde të reja.

Shefja e Zyrës së ShBA-së për Buxhet, Shalanda Young, ka thënë, në një letër dërguar udhëheqësit të Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, që nëse ndihma

ushtarake përfundon, atëherë Kievi do të gënjëzohet ndaj pushtimit rus.

Presidenti amerikan Joe Biden, demokrat, i ka kërkuar Kongresit në tetor që të miratojë një pako ndihme në vlerë të 106 miliardë

dollarëve për Ukrainën dhe Izraelin, mirëpo kongresistët janë të ndarë.

"Nuk ekziston një shportë magjike me fonde në këtë moment. Ne nuk kemi para - dhe gati as kohë", ka shkruar Young. "Mosdërgimi i armëve amerikane dhe pajisjeve të tjera do ta gënjëzojë Ukrainën në fushëbetëje, duke vënë në rrezik jo vetëm avancimet ukrainase, por duke e rritur mundësinë për fitore ushtarake ruse".

Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, Jake Sullivan, ka shkruar përtej, duke sugjeruar që vota kundër ofrimit të ndihmës për Ukrainën është, në fakt, votë për t'ia lehtësuar fitoren Rusisë. "Kongresi duhet të vendosë nëse do të vazhdojë lufta për lirinë e Ukrainës... ose nëse Kongresi do t'i injorojë mësimet nga historia dhe ta lejojë fitoren e Putinit", ka

thënë Sullivan në Shtëpinë e Bardhë. "Është aq e thjeshtë".

Kongresi amerikan është bllokuar në këtë pikë kryesisht prej ligjëvendësve të së djathtës ekstreme, të cilët refuzojnë të miratojnë ndihmë shtesë për luftën në Ukrainë, e cila po hyn në vitin e tretë.

Shtetet e Bashkuara kanë ndarë 111 miliardë dollarë për Ukrainën prej nisjes së luftës në shkurt të vitit 2022, përfshirë 67 miliardë dollarë për blerje të pajisjeve ushtarake.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përdimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 8 maj 2024

Shkup, 5 dhjetor - Zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 8 maj 2024, së bashku me raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Raundi i parë për zgjedhjen e presidentit të vendit do të zhvillohet më 24 prill. Kështu kanë vendosur partitë politike në një takim që ishte thirrur nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, njëherësh kryetar i Lidhjes Social

Demokrate në pushtet. "Duke pasur parasysh afatet ligjore dhe festat fetare që janë në këtë periudhë, ne u pajtuam për këto data të zgjedhjeve. Më në fund, pas 17 vjetëve, do të kemi zgjedhje të rregullta parlamentare dhe kjo flet për politika të mira të qeverisë", tha Kovačevski.

Njëqind ditë para zgjedhjeve, ose më 28 janar, do të formohet një qeveri teknike e kryesuar nga një

kryeministër shqiptar, i cili do të propozohet nga partia Bashkimi Demokratik për Integrim, që drejtohet nga Ali Ahmeti.

VMRO DPPMNE-ja kishte kërkuar që të mos ketë qeveri teknike, e cila po praktikohet në tri ciklet e fundit zgjedhore bazuar në atë që njihet si "marrëveshja e Përzhinës".


Data e zgjedhjeve pritet të dekretohet më së voni deri në fund të muajit dhjetor.



Kosova pëson rënie në testimin e PISA-s

'Rezultati i PISA-s, katastrofë arsimore. Analfabetizmi në Kosovë, në rritje'

Rezultatet e publikuara të testit PISA për vitin 2022 tregojnë se Kosova ka shënuar regres në fushën e arsimit, madje situata është edhe më e rëndë seç ka qenë në vitin 2018, kur ka qenë hera e fundit kur ka pasur matje. Kosova ka zënë vendin e 78 nga 80 shtete pjesëmarrëse, pra ka rënie nga viti 2018 për 11 pikë. Vendi ka zënë pozitën e 76 për lexim, në pozitën e 77 për shkencë si dhe në pozitën e 74 për matematikë. Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se pandemia e koronavirusit ka ndikuar në këtë rezultat. Ndërkaq përfaqësuesit e partive opozitare dhe shoqëria civile kanë thënë se ky rezultat është një katastrofë arsimore, duke theksuar se analfabetizmi në Kosovë është në rritje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kosova është renditur ndër të fundit në tri testet e programit ndërkombëtar për vlerësimin e nxënësve PISA. Kosova e ka zënë vendin e 74 në matematikë - fushën kyçe në testim dhe vendin e 76 në lexim. Në të dyja fushat, Kosova ka pësuar rënie në performancë me 11 pikë më pak në krahasim me testet e vitit 2018. Në shkencë, Kosova është renditur e 77-ta, me tetë pikë rënie. Singapori prin në të tria listat.

Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se pandemia e koronavirusit ka ndikuar në këtë rezultat. "Rezultatet, të cilat janë bërë publike sot, kanë qenë të pritshme, duke pasur parasysh se në këtë cikël të testimit, që u organizua në pranverën e vitit 2022, kemi pasur një situatë menjëherë pas pandemisë", ka thënë ajo në një konferencë për medie. Mes të tjerash, ajo ka përmendur se rezultat të ngjashëm kanë parashikuar edhe raportet vendore dhe ndërkombëtare, dhe se pandemia ka ndikuar në performancë edhe në vendet e tjera. "Në Kosovë ka pasur edhe situata të tjera, pandemia ka gjetur shkolla me sfida të ndryshme në implementim të teknologjisë, mësimi nga distanca, ndërrimet e

shumta në politikëbërje në qeverisje", ka thënë ajo. Nga Kosova kanë marrë pjesë 6027 nxënës nga 229 shkolla.

Testet PISA organizohen prej vitit 2000, dhe më 2022 është mbajtur cikli i tetë.

Ai ishte planifikuar të mbahej më 2021, mirëpo ishte shtyrë për shkak të pandemisë.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ka reaguar pas publikimit të rezultateve të testit PISA, duke theksuar ky rezultat është një katastrofë arsimore në Kosovë. Sipas ORCA-s, analfabetizmi në Kosovë është në rritje.

"Me shqetësim të madh, por të pabafesuar praniam rezultateve të PISA 2022 të cilat u publikuan para 1 ore në Paris nga OECD. Kosova ka shënuar rënie si nga rangimi ashtu edhe në performancë. Në vitin 2018 morën pjesë 74 vende dhe Kosova renditej e 72-ta ku 66% e nxënësve shënonin performancë të dobët, ndërkaq në vitin 2022 morën pjesë 80 vende dhe Kosova renditet e 79-ta pra e parafundit, ku 72.9% të nxënësve shënuan performancë të dobët. Analfabetizmi funksional është rritur fatkeqësisht, numri i nxënësve që nuk kuptojnë të lexuarit, nga 78% sa ka qenë në vitin 2018 është rritur në 83% në vitin 2022. Në matematikë kriza është thelluar, nxënësit kosovarë që kanë performuar nën nivel janë rritur nga 76% sa ishin në vitin

2018, në 85% në vitin 2022. Ndërsa në shkencë nga 76% në vitin 2018, numri i performuesve të dobët është rritur në 79% në vitin 2022", është thënë në reagimin e ORCA-s. ORCA shpreson se këto rezultate ta këndellin kryeministrin dhe qeverinë e tij ndonëse, sipas kësaj organizate, nuk beson se një gjë e tillë do të ndodhë duke pasur parasysh orientimin e qeverisë, e cila nuk konsiston në reforma radikale, por vetëm në fasadë që në ditë si kjo shembet para syve tanë. Edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguar pas rezultatit të PISA-s, duke theksuar se analfabetizmi qeveritar po prek shkollat tona. "Në testin PISA Kosova më keq se më 2014 e 2018. Sot u konfirmua rënia e thellë e rezultateve të nxënësve të Kosovës në testin e PISA-s në lexim, matematikë dhe shkencë. Kosova renditet, praktikisht, në fund të tabelës së 80 shteteve pjesëmarrëse. E dhembshme! E tmerrshme!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka theksuar se në secilën fushë ka rënie drastike të pikëve krahasuar me vitin 2014 dhe vitin 2018, kur është mbajtur për herë të fundit testi PISA. "Ne e kemi ditur, por tashmë edhe po dëshmohet, se qëllimi i kësaj Qeverie nuk ka qenë asnjëherë reforma arsimore e as përmirësimi i jetesës së qytetarëve tanë. Analfabetizimi

qeveritar, fatkeqësisht, tashmë po shkatërron edhe shkollat tona!", ka deklaruar Krasniqi.

Ish-ministrja e Arsimit, tash deputete e LDK-së në Kuvendin e Kosovës, Hykmete Bajrami, ka thënë se rezultati i PISA-s ishte i pritshëm sepse, sipas saj, në tri vitet e fundit viti shkollor ka nisur me një muaj vonesë. Ajo ka renditur katër pika në "Facebook" në lidhje me këtë problem. "1. Ministrja e Arsimit punën e parë si ministre e ka bërë duke shkelur Kushtetutën me kthimin prapa të reformës në arsim që e pati nisur Komuna e Kamenicës. 2. Veprimi i dytë i Nagavcit dhe i gjithë Qeverisë ka qenë mposhtja e SBASHK-ut dhe jo ngritja e cilësisë në arsim. Këtë betejë Qeveri-SBASHK e kanë paguar nxënësit, duke humbur mijëra orë mësimore. 3. Shkelësjja e Kushtetutës, pra ministrja Nagavci, bëri eksperimentin tjetër këtë vit me libra. Dhe, jemi në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe ende ka nxënës që shkon me libra të pakompletuar në shkollë. 4. Sot, kur po e komentojmë këtë rezultat të PISA-s, MASHT-i me të dhëna të veta konfirmon se në vendin tonë rreth 73% e paraleleve dhe 33% e shkollave nuk i plotësojnë kriteret ligjore për zhvillim të mësimin dhe ministrja ende s'ka ndërmarrë asnjë veprim për riorganizimin e rrjetit të shkollave", ka shkruar Bajrami.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se rezultatet katastrofale të testit PISA po nxjerrin në pah indiferencën e qeverisë së shpresës për çfarëdo investimi afatgjatë, nëse nuk është investim në spektaklin e liderit. "Asnjë lëvizje për të ndryshuar këtë gjendje, për të tjerët që s'janë në rrethin e ngushtë të lidërshiptit. Së pari villat në Marigona, pastaj klasat e çerdhet? E njohim këtë skenar. Është ditur në krye të herës kur e dekoroi Nagavcin me pozitën e ministres. Dekorim për besnikërinë partiake, asgjë më shumë. Rezultati në PISA është veç më i keq sesa në vitin 2018. U konfirmua kur e pengoi reformën në arsim në Kamenicë. A e keni vërejtur se si bash në arsim, zëvendësministrat njëri pas tjetrit japin dorëheqje, vasalja e Kurtit vazhdon monotoninë. 5 çerdhe nga 160 të premtuara. Shpërfillja totale nga ana e qeverisë për të investuar në arsim shihet prej larg", ka shkruar Molliqaj në "Facebook". Sipas tij, rezultatet e PISA-s nuk mund të mbeten vetëm numra. "Ato janë aktakuzë për një qeveri që i shërben vetëm një qytetari dhe një koalicioni të vogël ministrash e deputetësh për më shumë privilegje, më shumë begati. Një mentalitet i tillë e përjetëson dhe riprodhon gjendjen e rëndë në arsim në fund të listës", ka deklaruar Molliqaj.



Gjykatat “nuk e zbatuan udhëzuesin” në dënimet për terrorizëm

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka nxjerrë ende përfundime lidhur me vlerësimin e dënimeve të shqiptuara në rastet e veprave penale të terrorizmit, por pranon se Udhëzuesi për Politika Ndëshkimore, deri më tash, “nuk e ka gjetur zbatimin e duhur”. “Radio Evropa e Lirë” kërkoi reagimin e këtij institucioni pas publikimit të disa gjetjeve në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për terrorizmin në vitin 2022. Në pjesën për Kosovën, DASH-i ka vlerësuar se gjatë vitit të kaluar institucionet e drejtësisë kanë vazhduar të shqiptojnë dënime të ulëta për akuzat e lidhura me terrorizmin dhe lirime të parakohshme për këto akuzat. “Dënimet e shkurtra, lirimet e parakohshme dhe me kusht, si dhe joorganizimi i mbikëqyrjes pas lirimimit, paraqesin kërcënime për sigurinë”, ka vlerësuar raporti i DASH-it. Komisioni për Politikë Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës zotohet se do ta shqyrtojë mundësinë e analizimit të praktikës gjyqësore lidhur me veprat penale të terrorizmit, “për të dalë më pas me konkluzione rreth ashpërsisë së dënimeve të shqiptuara dhe trajtimit të këtyre rasteve”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës

(KGJK) e vlerëson shumë të rëndësishëm dhe të besueshëm raportin e DASH-it mbi praktikën e gjykatave vendore, ndërsa njohësit e çështjeve ligjore dhe të sigurisë thonë se gjeneza e problemit, të cilin e ka identifikuar DASH-i, ka të bëjë me “politikën kaotike ndëshkimore” në sistemin gjyqësor të Kosovës, e cila, sipas tyre, sjell rezultate joadekuat në shqiptimin e dënimeve.

Gjykata Supreme: Gjyqtarët ta shfletojnë udhëzuesin

Gjatë vitit 2022, sipas raportit të DASH-it, Kosova ka ndjekur penalisht një grua të riadhesuar me ndihmën e ShBA-së. “Edhe pse kjo grua është dënuar me dy vjet burgim, për shkak të bashkimit me grupin [militant] Shteti Islamik (IS), gjykatat e Kosovës i kanë dënuar të riadhesuarit me tre deri në katër vjet e gjysmë burgim për organizim dhe pjesëmarrje në aktivitetet terroriste të IS-it”, është thënë në raport. Po sipas tij, në qershor të vitit 2022 “Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar nga akuzat katër persona: dy kanë qenë të dyshuar për përgatitje të sulmeve ndaj klubeve të natës,

kishave dhe forcave të Kosovës, dy për vepra të tjera penale”. Ata janë liruar në mungesë të provave.

Sipas ligjeve në Kosovë, për vepra terroriste dhe kundër rendit kushtetues parashihen dënime të ndryshme. Që nga viti 2015 në Kosovë ndalohej, po ashtu, pjesëmarrja në luftëra të huaja - për të cilën vepër parashihen dënime deri në 15 vjet burgim.

Nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës thonë për “Radion Evropa e Lirë” se të gjitha raportet e DASH-it dhe rekomandimet trajtohen me seriozitet nga KGJK-ja dhe Gjykata Supreme. “KGJK-ja, së bashku me Gjykatën Supreme, po shikon mënyrat se si të monitorohen politikën ndëshkimore. Përveç kësaj, sistemi gjyqësor i Kosovës ka pasur zhvillime pozitive në luftën kundër terrorizmit, duke qenë njëkohësisht i vetëdijshëm se ende ka hapësirë për t'i adresuar çështjet e ngritura nga raportet e DASH-it”, thuhet në deklaratën e KGJK-së dërguar REL-it.

Ky institucion shton se “rezervohet t'i komentojë dënimet në rastet individuale”. Sipas tij, Gjykata Supreme është në fazën e rishikimit të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, “ku adresohet

edhe çështja për të cilën bëhet fjalë” në raportin e DASH-it.

Gëzim Shala, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi, i cili mbikëqyr punën e institucioneve të drejtësisë, thotë se Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2018 ka miratuar Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, ku ka përcaktuar qartësisht se si duhet të bëhet matja e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Në këtë udhëzues janë përcaktuar nevojat për respektimin e parimeve të dënimeve, rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, si dhe qëllimi i dënimeve. Siç thotë Shala, gjykatësit, gjatë marrjes së vendimit për dënime, nuk e kanë respektuar udhëzuesin për politikën ndëshkimore. “Ne kemi parë se në shumicën dërrmuese të rasteve është thuar se e kundërta e asaj që kërkon udhëzuesi, për shkak se këto përkrahje - sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit - janë kryesisht të përgjithshme dhe, thjesht, nuk mund të dihet se pse në një rast konkret është shqiptuar një dënim i caktuar. Kjo, më pas, sjell deri te ky rezultat, deri te një politikë ndëshkimore kaotike, që më pas reflektohet edhe në vlerësime negative, siç është rasti tani [me raportin e DASH-it]”, thotë Shala.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me vlerësimin se Udhëzuesi për Politika Ndëshkimore deri më tash “nuk e ka gjetur zbatimin e duhur”. “Moszbatimi i udhëzuesit padyshim që mund të ketë ndërlidhje me rastet e cituara në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Ndaj ne me ngulm kërkojmë nga gjyqtarët ta shfletojnë këtë udhëzues, pasi ai nuk përbën ndërhyrje në diskrecionin e tyre”, thuhet në deklaratën e Gjykatës Supreme dhënë “Radios Evropa e Lirë”. Sipas saj, “udhëzuesi, i cili e lehtëson punën e gjyqtarit, me theks të veçantë në caktimin e pikënisjes së dënimit, është në fazën përfundimtare të revidimit, pas ndryshimeve të Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale”.

Revidimi, siç thuhet, është duke u bërë nga Komisioni Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore, i mbështetur nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë.

“Sinjalet e gabuara” nga politika ndëshkimore dhe “risocializimi”

Në raportin e DASH-it thuhet se deri më tash Kosova ka riadhesuar mbi 120 shtetas nga kampet dhe qendrat e ndalimit

Këshilli i BE-së do t'i kërkojë Kosovës të bëjë më shumë për heqjen e masave

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Këshilli i Bashkimit Evropian do t'i bëjë thirrje Kosovës të bëjë më shumë në fushën e sundimit të ligjit si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërsa do ta mirëpresë hyrjen në fuqi të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit që po vjen. Kjo porosi është në draftin e konkluzioneve që pritet të miratohet nga vendet anëtare të BE-së në takimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, më 12 dhjetor, në nivel të ministrave, e të cilat pastaj pritet të konfirmohen edhe nga udhëheqësit e BE-së në një samit të paraparë për t'u mbajtur më 14 dhe 15 dhjetor.

"Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në draftin e këtij dokumenti. Aty thuhet se Këshilli "ka marrë parasysh progresin e kufizuar të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit".

Pjesa më e madhe e konkluzioneve, që i kushtohet Kosovës, ka të bëjë me situatën e sigurisë në veri të vendit dhe me dialogun me Serbinë.

Këshilli pritet që ta shprehë "shqetësimin për shkak të mungesës së lirisë së shprehjes dhe kufizimit e pluralizmit në veri të Kosovës". "Këshilli është thellësisht i shqetësuar për situatën në veri të Kosovës, përfshirë edhe atë të sigurisë. Disa veprime të njëanshme nga Kosova dhe nga Serbia, sikur edhe dorëheqja kolektive e serbëve të Kosovës nga institucionet, dhe bojkoti i zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, kanë shtuar edhe më shumë tensionet", thuhet në tekst.

Këshilli pritet t'i dënojë ashpër "sulmet e dhunshme të protestuesve serbë të Kosovës

ndaj trupave të KFOR-it, organeve të rendit dhe medieve, më 29 maj 2023". "Zgjedhjet e reja në veri të Kosovës duhet të zhvillohen sa më parë që të jetë e mundur, dhe serbët e Kosovës duhet të marrin pjesë në to, pa asnjë parakusht. Serbët e Kosovës, po ashtu, duhet të kthehen në institucionet nga të cilat janë larguar. Kjo duhet të lehtësohet nga Kosova dhe të inkurajohet nga Serbia", thuhet në draftin e konkluzioneve.

Sa iu përket masave të cilat BE-ja i ka vendosur ndaj Kosovës, të cilat janë arsyetuar me "mungesën e hapave për ta shtensionuar situatën në veri", shprehet gatishmëria që ato masa të hiqen në rast se do të ketë progres për përmbushjen e kërkesave. "Këshilli mirëpret ndërmarrjen e hapave drejt zbatimit të disa kërkesave të BE-së. Këshilli rikujton se BE-ja mbetet e gatshme t'i heqë masat në rast të progresit të mëtijmë për përmbushjen e kërkesave ekzistuese", thuhet në tekstin që ka parë "REL"-i.

Këshilli, edhe përmes këtyre konkluzioneve, pritet të përsërisë se nuk ka justifikim për dhunë, dhe t'i dënojë sulmet ndaj Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit më 24 shtator. "Këshilli nënvizon përmirësimin e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe EULEX-it lidhur me këtë sulm. Këshilli mirëpret forcimin e pranisë së KFOR-it, posaçërisht në vijën kufitare/administrative mes Kosovës dhe Serbisë", thuhet në tekst, ku, po ashtu, i bëhet thirrje edhe Kosovës, edhe Serbisë, që të përmbahen nga retorika nxitëse.

BE-ja mund të ndërmarrë masa si ndaj Kosovës ashtu edhe ndaj Serbisë në rast se nuk

përmbahen nga nxitja e tensioneve. "Këshilli pret nga Kosova dhe Serbia të gjejnë një zgjidhje të qëndrueshme për situatën në veri të Kosovës, e cila do të garantonte siguri dhe demokraci përfaqësuese për të gjithë qytetarët", thuhet në tekst. "Këshilli kërkon nga Kosova të angazhohet në dialogun e lehtësuar nga BE-ja me vullnet të mirë dhe në frymën e kompromisit, për të arritur marrëveshjen gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese me Kosovën, për normalizimin e raporteve, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e BE-së, pa vonesa tjera. Kjo Marrëveshje duhet të adresojë të gjitha çështjet kyçe të hapura, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në stabilitetin e rajonit", thuhet në këtë dokument, ku rikujtohet se të dyja palët do ta rrezikojnë

rugëtimin e tyre evropian në rast se nuk e shfrytëzojnë këtë rast.

Këshilli pritet të shprehë keqardhje për mungesën e zbatimit nga të dyja palët të Marrëveshjes bazë për normalizimin e raporteve dhe të aneksit, sikur edhe çështjeve të tjera të arritura në dialog. "Kërkojmë nga Kosova që, në tërësi dhe pa vonesa të tjera, t'i zbatojë ato. Kjo përfshin edhe themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe. Këshilli mirëpret gatishmërinë e Kosovës dhe të Serbisë për të pranuar draftin e paraqitur nga lehtësuesi i BE-së, duke kuptuar se punë e mëtejme duhet të bëhet në bazë të tij", thuhet në tekst.

Këshilli pritet ta ftojë përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë që ta plotësojë agjendën për takimin e radhës të Grupit

Special për Normalizim, për t'i marrë parasysh obligimet e Kosovës që dalin nga Marrëveshja dhe aneksi i zbatimit të saj.

Kosova pritet të ftohet urgjentisht dhe në mënyrë konstruktive të angazhohet në aktivitetet e bashkëpunimit rajonal dhe t'i respektojë obligimet nga Marrëveshja për Tregti të Lirë - CEFTA dhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, përfshirë edhe duke hequr vendimin për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia.

Këshilli i BE-së pritet ta përhëndesë orientimin e qartë gjeostrategjik të Kosovës, që është dëshmuar edhe përmes dënimit të ashpër të agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës, dhe përmes përshtatjes vullnetare të qëndrimeve të saj në politikën e jashtme me ato të Bashkimit Evropian.



në Siri. Sipas këtij raporti, 80 shtetas të tjerë vazhdojnë të jenë në kampet e të zhvendosurve apo në qendrat e ndalimit, ose në fushëbeteja në Siri.

Ekspteri i çështjeve të sigurisë, Drizan Shala, nga Asociacioni i Kriminologëve dhe Kriminolistëve të Kosovës, thotë se raporti i DASH-it me të drejtë paralajmëron "kërcënime për sigurinë". Ky raport, sipas tij, duhet të jetë alarm për institucionet e Kosovës.

Ai thotë se "dënimet e ulëta" ose ato alternative, si dhe elementet progresive dhe pozitive për risocializimin e atyre që kanë qenë të akuzuar për veprën penale të terrorizmit, përçojnë "sinjale të gabuara" tek individët apo grupet e caktuara, "që shoqëria kosovare do ta tolerojë vazhdimin edhe më tej të aktiviteteve të tyre, mbi bazën e bindjeve dhe doktrinave që ata kanë mësuar ose trashëguar gjatë kohës sa kanë qenë pjesë e grupit militant Shteti Islamik",

edhe pas lirimimit nga vuajtja e dënimit. "Shteti e ka të pamundur kontrollimin e gjithsecilit, pavarësisht se janë krijuar mekanizma, drejtori, instrumente, të cilat bëjnë që shteti të tentojë t'i mbikëqyrë. Por, në një moment të caktuar, ka mungesë të kuadrove profesionale dhe kjo mundëson më pas që këta persona të rigrupohen, të riorganizohen, t'i rimodelojnë strategjitë e tyre, si dhe të mësuarat dhe përvojat që kanë fituar gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre terrorist në Lindjen e Mesme dhe t'i praktikojnë në një moment të caktuar", thotë Drizan Shala.

Aktualisht, pa strategji për luftimin e terrorizmit

Raporti i DASH-it, gjithashtu, përmend mungesën e një strategjie të Kosovës për t'i adresuar kërcënimet e lidhura me terrorizmin. Kosova e ka pasur një strategji të tillë për

periudhën 2018-2023.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar Qeverisë së Kosovës dhe ka kërkuar një koment lidhur me gjetjet në raportin e DASH-it, por nuk ka marrë përgjigje. Qeveria nuk i është përgjigjur as pyetjes se a është duke u punuar për strategjinë e re shtetërore kundër terrorizmit.

Gëzim Shala, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, vlerëson se Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht ta marrë në konsideratë rekomandimin që del nga raporti i DASH-it lidhur me strategjinë për luftë kundër terrorizmit. "Ajo që kërkohet është një bashkëpunim i gjerë ndër-institucional dhe një angazhim i të gjitha institucioneve, që në përputhje me ligjin dhe standardet e mira ndërkombëtare, t'i trajtojnë këto raste dhe jo përmes miratimit të politikave, të ligjeve të caktuara, të cilat më pas dështojnë ta japin efektin e tyre në praktikë", thotë Gëzim Shala.

Sipas kriminologut Drizan Shala, institucionet e Kosovës duhet pasur kujdes për hartimin e strategjisë së re kundër terrorizmit dhe ta kenë parasysh që terrorizmi ka evoluuar në formë të ndryshme. Sipas tij, strategjia e re duhet ta ndjekë trendin e kërcënimit dhe mbi atë bazë të përcaktohet qartë se si duhet të veprojnë institucionet. "Të gjithë ata [individë] që kanë kaluar nëpër sistemin hetimor, prokurorial dhe gjyqësor, tashmë i kanë kuptuar mundësitë dhe mangësitë e sistemit, pra se si mund t'i ikin dhe çfarë nuk duhet bërë... Duhet të dihet se ata do të jenë të kujdesshëm në fushëveprimtarinë e tyre për t'i ikur radarit të institucioneve përkatëse, të cilat e kanë për detyrë luftimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve terroriste në Republikën e Kosovës", thotë Drizan Shala.

Nga viti 2011, për disa vjet me radhë, më shumë se 350 shtetas të Kosovës kanë udhëtuar drejt

Sirisë dhe Irakut. Është thënë se shumica prej tyre janë rreshtuar përkrah grupit militant Shteti Islamik.

Në prill të vitit 2019 Kosova ka kthyer 110 shtetas nga Siria, në mesin e të cilëve katër luftëtarë të Shtetit Islamik, 32 gra dhe 74 fëmijë, ndërsa në korrik të vitit 2021 autoritetet kanë riatdhesuar edhe 11 shtetas nga Siria. Sipas të dhënave të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), të publikuara në mars të vitit 2023, "shumica e të kthyerve, me të arritur në Kosovë, janë arrestuar dhe u janë nënshtruar proceseve gjyqësore kundër tyre". Sipas QKSS-së, një pjesë e tyre tashmë e kanë vuajtur dënimin në burg, por duke marrë parasysh "nivelin e rrezikshmërisë që këta individë dhe kauza të cilën ata e përkrahën, paraqesin për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe aleatëve të saj, institucionet e Kosovës obligohen ta monitorojnë procesin e ndjeshëm të rehabilitimit të tyre dhe rikthimit në komunitet".

KRU 'Prishtina' inspekton bizneset e vogla dhe të mëdha në Podujevë për pagesën e ujit

PODUJEVË, 5 DHJETOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Prishtina' ka ndërmarrë një aksion në qytetin e Podujevës për

inspektim të bizneseve të vogla dhe të mëdha. "Shembuj të shkëlqyeshëm disa ordinaanca private stomatologjike, fitnese,

bukëpjekës etj. Përveç pages të rregullt, disa edhe në parapagim. Në të njëjtën kohë disave iu dërguan edhe vërejtjet e fundit për

shkycje nga shërbimet për shkak të mospagesave për ujë", ka njoftuar KRU 'Prishtina'.



Nënshkruhen kontratat me 160 studentë përfitues të bursave

DRENAS, 5 DHJETOR - Në Sallën e Kulturës në Drenas studentët përfitues për vitin akademik 2023/2024 kanë nënshkruar kontratat për marrjen e bursës komunale. Me rastin e nënshkrimit të kontratave ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, i cili edhe ka bërë nënshkrimin e kontratave për 160 bursa të nivelit të studimeve bachelor. Kryetari Lladrovci gjatë procesit të nënshkrimit të kontratave para studentëve tha se ndihet krenar me numrin e madh të të rinjve të cilët kanë interesimin për të studiuar. "Arritja e të rinjve në fushën



profesionale në studime është arritje edhe e familjes dhe komunës së Drenasit", ka thënë Lladrovci.

Ai i ka përgëzuar përfituesit e bursave që kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Kryetari Lladrovci ka shtuar se komuna e Drenasit vazhdimisht ka qenë e angazhuar për përkrahjen e studentëve në fushën e dijes, duke rritur secilën herë numrin e përfituesve sipas mundësive buxhetore dhe do ta vazhdojnë këtë traditë për t'ua lehtësuar sadopak barrën studentëve dhe familjeve të tyre për të studiuar.

Aktivizohet shërbimi i Gjinekologjisë dhe Radiologjisë në QKMF-në në Kaçanik



KAÇANIK, 5 DHJETOR - Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kaçanik është aktivizuar shërbimi i Gjinekologjisë dhe i Radiologjisë. Nënkryetari i komunës, Sabedin Vishi, ka theksuar se aktivizimi i këtyre dy shërbimeve shënon një hap shumë të rëndësishëm për

përmirësimin e kushteve shëndetësore komunale dhe rritje të këtyre shërbimeve. "Mjekët e angazhuar janë dr. gjinekologe Paulina Lumezi e cila do të punojë nga dita e martë deri të premtën duke filluar nga ora 8:00, ndërsa dr. Mentor Trena - radiolog - do të

punojë çdo të premte nga ora 16:00. Mjekët e angazhuar i uruan për punë të mbarë edhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Sali Malsiu dhe drejtori i QKMF-së, dr. Sinan Zeneli", thuhet në njoftimin e komunës së Kaçanikut.



Mbahet punëtorja për hartimin e planit të punës për Kuvendin e Komunës së Rahovecit për vitin 2024

RAHOVEC, 5 DHJETOR - Të martën është mbajtur punëtorja "Hartimi i planit të punës për Kuvendin e Komunës së Rahovecit për vitin 2024" që parashihet me kornizën ligjore në Kosovë. Në këtë punëtori morën pjesë grupet parlamentare të partive të përfaqësuara në kuvend, drejtorët

komunalë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët patën mundësinë të propozojnë pika për përfshirje legislative, të pajtohen për prioritetet dhe objektiva të punës së kuvendit. Kjo punëtori është organizuar nga OSCE-ja dhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Nis implementimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet UP-së dhe RTK-së

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Grupi i parë i studentëve të Departamentit të Gazetarisë ka nisur punën praktike në Radiotelevizionin e Kosovës falë marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe RTK-së, e nënshkruar në korrik të këtij viti.

Praktikantëve iu uruan sukses

prorektorja Njomza Llullaku, drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj, asistentja e Departamentit të Gazetarisë, Blerta Dibrani, udhëheqësja e Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Komunikim në RTK, Gentiana Begolli dhe menaxheri për marrëdhënie ndërkombëtare në RTK, Bekim Shehu.

Praktika e studentëve do të vazhdojë edhe në muajt në vijim, me grupe të tjera të studentëve. Gjatë takimit u diskutua edhe rreth implementimit të pikave të tjera të memorandumit, siç janë organizimi i aktiviteteve të përbashkëta dhe sigurimi i mbulueshmërisë mediatike për aktivitete që i shërbejnë interesit publik.



Ambasada Amerikane: Mbështetim tranzicionin ambicioz energjetik në Kosovë

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ambasada Amerikane në Prishtinë ka njoftuar se pret me padurim investimin në sektorin energjetik përmes programit kompakt nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) në Kosovë.

Ambasada Amerikane e ka quajtur këtë investim të rëndësishëm në sektorin energjetik të vendit. "Ne jemi duke punuar me Qeverinë e Kosovës për ta mbështetur tranzicionin ambicioz energjetik në Kosovës", thuhet në njoftimin e

Ambasadës Amerikane. Programi Kompakt kap vlerën prej 236.7 milionë dollarësh dhe është investimi më i madh i pasluftës në fushën e energjisë, i cili do të ketë rol strategjik në procesin e tranzicionit energjetik në Kosovë.



Kurti: Sistemi i drejtësisë të japë dënime meritore për dhunuesit dhe për kriminelët

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Me një minutë heshtje për vrasjen e Liridona Ademajt, e nisi fjalën e tij kryeministri Albin Kurti në konferencën rajonale, bashkorganizim i Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Presidencës, me temën "Të bashkuar kundër dhunës - Mjaft!".

Kurti tha se zbardhja e plotë e rastit të Liridonës është drejtësi. "E i drejtë presim të jetë dënimi, pra maksimal", është shprehur ai, teksa i shprehi edhe një herë ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe uroi shëndet për fëmijët e saj.

Kurti ka theksuar se po punojnë për krijimin e një mjedisi ligjor të fuqishëm kundër dhunës me bazë gjinore, duke plotësuar dhe ndryshuar kodin e procedurës penale, duke ashpërsuar masat për kryesit e veprave penale të dhunimit,

dhunimit seksual dhe të dhunës në familje.

Në të njëjtën kohë ai ka thënë se është përmirësuar qasja në shërbime sociale duke ngritur mbështetjen për këto shërbime dhe duke siguruar qëndrueshmëri financiare për strehimoret e të mbijetuarave të dhunës në familje përmes rritjes së buxhetit dhe linjës së veçantë buxhetore për to.

Megjithatë, kryeministri shtoi se ka nevojë që i tërë sistemi i drejtësisë ta bëjë prioritet trajtimin e rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe grave dhe të japë dënime meritore për dhunuesit, për kriminelët. "Nuk kemi si ta themi më prerazi që na duhet dënim meritor. Butësia e dënimit po shkakton përsëritjen e krimit. Vënia e drejtësisë është kusht i domosdoshëm për një shoqëri të lirë dhe demokratike, çfarë ne duam të jemi dhe do të aspirojmë të mbetemi përherë", u shpreh Kurti.



Franca rrit nivelin e rrezikut nga gripi i shpezëve



PARIS, 5 DHJETOR - Franca e ka rritur nivelin e rrezikut për gripin e shpezëve nga "i moderuar" në "të lartë" pas identifikimit të rasteve të reja të sëmundjes, ka thënë Ministria e Bujqësisë të martën, duke i detyruar fermerat t'i mbajnë zogjtë në ambiente të brendshme për ta parandaluar infektimin.

Influenza Avian, e njohur shpesh si gripi i shpezëve, ka rezultuar me asgjësimin e qindra miliona zogjve në gjithë botën vitet e fundit. Ajo zakonisht përhapet në vjeshtë dhe dimër dhe është identifikuar në shumë shtete evropiane në javët e fundit, përfshirë Gjermaninë,

Holandën dhe Belgjikën.

Franca ka thënë javën e kaluar se e ka identifikuar rastin e parë të prekur me këtë virus në veriperëndim të shtetit.

Rritja e nivelit të rrezikut nënkupton se të gjithë shpezët duhet të mbahen në ambiente të mbyllura dhe duhet të merren masa mbrojtëse shtesë për ta shmangur përhapjen e sëmundjes.

Ndonëse grupi i shpezëve nuk shkakton dëme në ushqim, përhapja e tij përbën shqetësim për qeveritë dhe industrinë e shpezëve për shkak të dëmeve që mund të shkaktojë në tufat e shpezëve, në tregti të mishit dhe në bartje eventuale të njerëzimit.

Haradinaj: Shqipëria gjithmonë ka qenë mbështetëse e pakursyer e Kosovës

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në zyrat e partisë ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj. "Duke i uruar

mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kosovë, me ambasadorin Malaj diskutuam për zhvillimet që po kalon Kosova, Shqipëria dhe rajoni dhe për proceset që

na presin, veçanërisht për sfidat e Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe perspektivën euroatlantike", ka thënë Haradinaj pas takimit. Ai ka theksuar se

Shqipëria gjithmonë ka luajtur rol konstruktiv duke qenë mbështetëse e pakursyer e Kosovës në të gjitha fazat e lirisë dhe shtetndërtimit të saj.



Baca Adem Demaçi dhe Adem Jashari, të padëshiruar në Prishtinë!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Adem Demaçi në Podujevë, Adem Jashari në Tiranë: Në historinë e re të shqiptarëve të Kosovës ishin dy emra të përveçëm që i dhanë kuptim luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, Komandanti Politik, Bacë Adem Demaçi dhe Komandanti Ushtrarak, Adem Jashari. Të tjerët ishin bashkëveprimtarë dhe bashkëluftëtarë të tyre kurse ndërsa pati edhe përfitues ordinerë sikur këta që u konvertuan nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës në LDK. Pjesa kombëtare e LDK-së luftoi sikur të gjithë ushtarët e së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës kurse ajo përfituese e quajtur FARK (Forcat e Armatosura të Kolumbisë) "luftoi" nëpër stanet dhe mrizet e Shqipërisë, pa e shkrepur asnjë plumb për Kosovën. Baca Adem Demaçi bëri afërsisht 29 vjet burg në kampet përqëndruese të ish-Jugosllavisë ndonëse këta këlyshët e Titos që janë bërë pjesë e kotillës politike të qeverisë aktuale thonë se Baca dhe të burgosurit tjerë nuk ishin në burgje por në hotele. Madje, njëri prej tyre pati deklaruar publikisht se Baca Adem Demaçi tërë burgun e ka mbajtur në hotel Moska në Beograd. Jo në ndonjë hotel tjetër si Mazhestik psh. por në hotel Moska, për të tingëlluar më bindës në poshtërsinë e tyre. Bënin përpjekje që Bacën Adem Demaçi ta nxjerrin më të privilegjuar se rrogëtarët e bindur të Titos dhe Rankoviçit, Ali Shukrinë, Sinan Hasanin, Fadil Hoxhën, Mehmet

Maliqin, Kolë Shirokën dhe patriotët e tjerë të kombësisë jugosllave pasardhësit biologjikë dhe politikë e të cilëve sot janë benjaminë të Albin Kurtit, nga kryeministri i vërtetë në hije, Jeton Qurroi, me bijë dhe bija e deri te ambasadori mashtrues në Bruksel, i rritur dhe dresuar me pedigrenë e Qurroit. Ky farë Qurroi Bacën Adem, në një gazetë pornografike politike nga e cila u bë milioner e pati shpallë Bacën se është kundër krejt botës shkak se e pati refuzuar Konferencën e Rambujesë. Bashkë me shkrimtarin e adhuruar të shokut Enver, disidentin e demokracisë, Mal Padare Padrino që iku në Paris me vijën e rregullt të fluturimit Tiranë - Paris. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Baca Adem Demaçi ishte marginalizuar politikisht nga thuaja të gjithë. Përrashtim bënin, në rrafshin lokal Shpejtim Bulliqi që qysh para 20 vjetëve kishte parashikuar se do të bëhej kryetar i Podujevës dhe se do ta vendoste përmendoren e Bacës, në qendër të Podujevës, para kafetarisë "Baron" e jo në Parkun në Qendër si ishte marrëveshja paraprake. Pastaj, KM i Kosovës, Albin Kurti i bëri të gjitha përpjekjet që ta bëjë Bacën president të.....Kurdistanit por nuk i siguroi votat përkundër sakrificës së madhe. Thonë se historia në të shumtën e rasteve përsëritet si farsë por në rastin e inaugurimit të përmendores së Bacës Adem Demaçi në Podujevë ia kalonte edhe farsës fantastike. Kush do të thoshte dhe do të besonte se thuaja pas 20 vjetëve, Shpejtim Bulliqi dhe Albin Kurti do ta zbulojnë përmendoren e Bacës Adem?! Këtë nuk e kanë paraparë as Baba Vanga e as Nostradamusi e lëre më ne që i kemi besuar deri në qiell Albin Kurtit.

Si shkuan gjërat gjatë këtij manifestimi: Kohëve të fundit, sidomos pasi Baca kishte rënë

shumë me shëndet, shumë pak shokë i qëndruan afër Bacës, simbolikisht pak. Unë, Behxhet Sh. Shala, nuk i jam ndarë për asnjë çast deri në kohën kur iku në përjetësi. Edhe më shumë i kanë ndenjur afër ime shoqe, Fexhrije Shala e keqtrajtuar brutalisht si e burgosur politike në Mitrovicë dhe Prishtinë nga baballarët e bijave dhe bijve që sot janë sistemuar në institucionet kryesore të Kosovës, në Qeveri, në Kuvend dhe në Presidencë. Edhe më tutje po keqtrajtohet nga kotilla politike projugosllave dhe proserbe në vendin ku punon. Për Bacën kujdeseshin shumë Shkëmbi dhe Blini sidomos kur qëndronte në shtëpinë tonë e nuk ka qëndruar pak. Për çështje të mëdha politike (për Kinën psh.) Baca më përjashtonte nga debati dhe deri në mëngjes bisedonte me Shkëmbin dhe Blinin. Flisnin si ua donte dëshira dhe jo si ishin mundësitë. Para disa muajve përfolej se Kuvendi Komunal i Podujevës ka ndarë mjete për ta ngritur përmendoren e Bacës në Podujevë ndonëse Baca Adem Demaçi as nuk kishte lindur në Podujevë, as nuk ishte rritur aty por ishte i lindur në Prishtinë, ishte shkolluar në Prishtinë, kishte vepruar kryesisht në Prishtinë dhe kishte ndërruar jetë në Prishtinë. Edhe familjen e kishte krijuar në Prishtinë dhe fëmijët kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë në Prishtinë, sikur edhe nipërit dhe mbesat dhe të afërmit. Ata pak shokë të Bacës Adem Demaçi e kundërshtuan këtë zhvendosje të Bacës nga Prishtina në Podujevë si përpjekje për marginalizim duke e shndërruar në simbol lokal. Këmbëngulnin (dhe kishin të drejtë) se fillimisht Baca Adem duhet të përjetësohej në Prishtinë e pastaj, nëse është e nevojshme edhe në qendrat tjera. Mirëpo, Prishtina u tregua e pasjellshme dhe mosrespektuese e sakrificës sublime të dy komandantëve të

çështjes kombëtare, Adem Demaçi dhe Adem Jashari duke i shpallur persona non grata për Prishtinën. Si rrethanë rënduese e morën angazhimin e tyre dhe sakrificën për liri dhe çështje kombëtare. Sa të poshtër dhe të pandjeshëm që u treguan! Kur u caktua koha për inaugurimin e përmendores së Bacës Adem Demaçi në Podujevë, disa shokë që mbanin qëndrim kundërshtues të marginalizimit të Bacës duke e zhvendosur në Podujevë, refuzuan të marrin pjesë në këtë inaugurim. Argument shtesë të këtij refuzimi ishte fakti se nuk donin të bëhen pjesë e fushatës elektorale të Shpejtim Bulliqit dhe Albin Kurtit. E kishin këtë të drejtë. Përkundër qëndrimit të fort që e kam për Bacën, Adem Jasharin, UÇK-në dhe ushtarët e lavdishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë, Behxhet Sh. Shala, ime shoqe, Fexhrije Shala, djemtë tanë, Shkëmb dhe Blin Shala si dhe nusja e madhe Mile Fetahu - Shala shkuam në inaugurim dhe, në të njëjtën kohë u bëmë pjesë e fushatës elektorale të personave të përmendur disa rreshta më lart. Më bëri përshtypje ndryshimi i datës së inaugurimit, së pari ishte data 28 nëntor kurse shkak se KM i Kosovës po atë ditë shkonte në Vlorë dhe gjetiu, inaugurimi u bë më 26 nëntor 2023. Llapjanët kishin vendosur disa rreshta me karrige për familjarë dhe për ata që tërë kohën e kishin përndjekur politikisht Bacën Adem. Ne që thuaja tërë kohën ishin logjistikë jetësore dhe kombëtare e Bacës ishim në margjina, siç ishte edhe Baca pas përfundimit të luftës në Kosovë. Madje, më kritikuan disa të njohur pse nuk kisha marrë pjesë në inaugurim sepse dioptria e tyre kapte hapësirën vetëm para shtatores së Bacës ku ishin KM, Albin Kurti, Shpejtim Bulliqi dhe një pjesë e ogjiqit politik të KM. Unë, thellë në margjina e takova Fehmi Blakçorin, Albinot

Malokun, Avdi Gjatën, djalin e bacës Avdi Monolli, vëllanë e Isa Jasharit që ishte dënuar me mua dhe disa shokë që nuk i kisha parë një kohë të gjatë. Këta edhe ma ndreqën ditën ndryshe do të ishte dënim i madh për mua të duroj edhe një minut të vetëm në mesin e persekutuesve politikë të Bacës Adem Demaçi që çaravesheshin pa asnjë shije dhe pa iu skuqur fare fytyra. Realisht fytyra iu skuqej, jo nga turpi por nga i ftohti. Në kthim e sipër KM i Kosovës sa nuk u fërkua me mua, pa më parë, deri sa shkoi te xhipi, Shvarc i zi, ndërsa anash rrinin policët e njësisë speciale që, nëse nuk bëjnë asgjë, së paku do ta vrisnin me snajper dikën që mund ta rrezikonte eventualisht KM e Kosovës. Rrezikun e vetëm e pata kur një ish huligan, tash me rroba të policisë së Kosovës, në përpjekje për t'i pëlqyer KM Kurti (siç ka bërë edhe me kryeministrat tjerë), thuaja se na nxori nga rruga kryesore. Çfarë sjellje prej rruqaci në kohën që, po të ishte nevoja shtatë shpirtrat e maces do t'i jipja në mbrojtje të KM të Kosovës. Shkëlqesisë së Tij (gojëkëqijtë thonë të ndryshkur), Albin Kurtit. Por, siç thoshte bartësi i dy shtatoreve në Prishtinë, njëra përballë Kuvendit të Glauk bin Sherifit dhe tjetra para Katedrales, si Misionar i Paqes, Ibrahim Rugova. "Falë Zotit edhe kësaj here shpëtuam ...".

Mashtrimi i vitit: Përkundër se janë të ndaluara me ligj lojërat e fatit, komuna e Prishtinës organizoi një garë me short për bizneset gastronomike që do të fitojnë hapësirë në sheshin bri Katedrales. Realisht ishte një trukim i zakonshëm ku vendet i fituan të gjithë ata që i kishin fituar edhe më parë. Në rastin konkret, tërheqja e shortit vërtetë historia u përsërit si farsë. Madje, nuk mungoi as "bukë e zemër..." e dhe kotillës së tij politike ndonëse ...hetimet vazhdojnë!



Recension i librit Barazia dhe Drejtësia Gjinore



Dr. Sc. Salihe SALIHU

Akademikja Aurela Anastasi na vjen me një libër me sqarime të nevojshme për temën që është në fushën e të drejtave të njeriut dhe një ndër parimet kryesore në Konventa dhe Rezoluta Ndërkombëtare. Autorja që në fillim tregon se pse u përcaktua për trajtimin e kësaj teme specifike, "Barazia dhe Drejtësia Gjinore". Brenga e saj është e lidhur me faktin që ende ekziston boshllëk në mes barazisë dhe drejtësisë gjinore në Shqipëri edhe pse barazia është e sanksionuar me ligje të vçanta të cilat derivojnë nga Kushtetuta e vendit.

Autorja brengën e saj rreth kësaj teme e drejton kah institucionet gjyqësore meqë ato nxjerrin verdikun për të garantuar Barazinë e për ta fuqizuar Drejtësinë Gjinore. Akademikja Aurela tenton ta ngrisë dyshimin në pritshmëritë që vetëm ligji me një gjuhë neutrale mund ta rregullojë këtë dimension të barazisë me drejtësi. Garancia ligjore nuk është i mjaftueshëm meqë ka rrezik që të sfidohet nga realiteti social që është i

përmbushur me stereotipa gjinorë.

Në Shqipëri në listën e gjatë në pakon e reformave ligjore dhe institucionale të cilat kanë filluar në shekullin XXI nuk kanë arritur që të ndryshoj mentalitetin rreth barazisë gjinore e rrjedhimisht gjyqësori ballafaqohet akoma me këtë problematik. Autorja në libër shpreh shqetësimin e saj rreth këtyre sfidave dhe pohon se shoqëria shqiptare ka nevojë të madhe për të ngritë ndërgjegjësimin dhe për të respektuar normat juridik të barazisë.

Dilema tjetër është pranimi qënësor i barazisë në rradhë të parë si koncept. Barazia nuk është e mjaftueshme nëse nuk është barazi në të gjitha sferat por është edhe më e lëndueshme kur nuk kuptohet thellësisht dhe drejtë thelbi i konceptit barazi. Prandaj autorja hedh vëzhgimin analitik duke filluar nga familja, në të drejta pronësor, në përfaqësimin gjinor në vendim-marrje si dhe në institucionet shtetërore.

Objekt analitik në libër është kushtetëzimi i barazinë për ti mbrojtur barazinë gjinore nga diskriminimi që i behet për shkak të përkatësisë biologjike dhe sociale; kushtetëzimin e barazisë për mundësi të barabarta; kushtetëzimin për masa pozitive dhe promovimin e barazisë së rezultateve si dhe kushtetëzimi i shkaqeve të mbrojtura në një "listë të hapur".

Në trajtim të temës autorja ka sjell

shembuj të shumtë ilustrativ se në çfarë mënyre Gjykata Evropiane, Gjykata e Luxemburgut apo Gjykata e Lartë e ShBA-ve i trajton parimin e barazisë gjinore me qëllimin e vetëm për të siguruar "de facto" barazinë mes burrave dhe grave.

Përgjithësisht mendohet, që barazia në drejtësi është trajtim vetëm për gjininë femrore. Por, në fakt, autorja flet për barazinë dhe drejtësinë gjinore për dy gjinitë duke prekur trajtimin e drejtësi jo vetëm ndaj femrave por edhe drejtësinë ndaj meshkujve. Me këtë qasje neutraliteti ndaj përkatësisë bëhet mbrojtja pure e drejtësisë gjinore, duke prek nevojën për të mbrojtur të drejtën prindërore edhe gjatë procedurave të divorcit, duke vu në pah se kjo e drejtë nuk është e drejtë të mohohet as njëjërë gjini. Si ilustrim për të dëshmuar shkelje të këtilla e ilustron me shembullin tek rasti Bajrami, i cili kishte vdekur pa e takuar fëmijën.

Problemet për zbatimin e barazisë dhe drejtësisë gjinore gjatë procedurave të divorcit është segment tetër në trajtim. Pengesat në bashkëpunimin ndërkombëtar janë të pakuptueshme. Zbatimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore nuk është efektiv as në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Konventa e Hagës të cilën Shqipëria e ka ratifikuar dhe ende nuk zbatohen në plotshmëri.

Autorja povencon për nevojën që krahas masave të veçanta me ligj të

ekzistojnë edhe detyrime ligjore për eliminimin e diskriminimit dhe për zbatimin e ligjeve të barazisë gjinore. Për shembull në Shqipëri, në Akademinë e Shkencave, përveç masave pozitive janë edhe detyrimet ligjore. Përmes masa të posaçshme procedurale në Statutin e ASH sigurohet përfaqësimi i grave në organet përfaqësuese të këtij institucioni dhe zgjedhjet e anëtarëve të Asamblesë zhvillohen në përputhje me parimin e barazisë gjinore.

Përtej vendosjes së pozitive sipas meritokracisë në institucionet shtetërore është shtruar nevoja për zgjerimin e të drejtave gjinore edhe në dimensionin ekonomik. Autorja bazohet në Traktatin e Romës dhe arrinë të nxjerrë në pah edhe dimensionin e të drejtave të femrave në rastet kur ato lindin fëmijë. Duke e analizuar kërkesën për sigurimin e shoqëror të femrave lehona me pagë 100% fuqizohet jepet një mbështetje me automatizëm e poashtu duke i dhënë të drejtë për ta legjitimuar këtë kërkesë. Vetë analiza e këtij aspekt është një apel drejtuar institucioneve shtetërore që ti lejohet femrave të kompensohen me pagë më të lartë me qëllim të kompenzimit edhe të humbjeve profesionale që shkaktohen si rezultat i largimit të tyre nga puna. Mirëpo e gjithë rëndësia për ta spikatur barazinë bie te organet e drejtësisë. Autorja e vënë në theks edhe nevojën për gjyqtarë të

paanshëm dhe detyrimi për respektimin e paanshmërisë edhe të etikës gjyqësore që duhet të përkon me sjelljen e paanshëme të gjyqëtarëve në proceset gjyqësore. Në libër, gjithashtu, janë vënë në dukje edhe interpretimet e gabuara të ligjeve nga ana e gjyqëtarëve që nuk e japin vendim e duhur përkundër garantimit të drejtës gjinore në Kushtetë. Shembuj të interpretimeve të gabuara ka përplot por si ilustrim përmendet rasti i keqinterpretimit të njohjes së atësisë në kuadrin e drejtës familjare.

Vështrimi i Barazisë dhe Drejtësisë Gjinore në këtë trajtim është kryekëput i mbështetur në Kushtetutë si bazament themeltar i çdo shteti. Përmes këtij trajtimi shpresojmë që organet e drejtësisë të kushtohen më vëmendshëm në specifikat në relacion gjinor për ta zbatuar parimin e barazisë si element i domosdoshëm për drejtësi gjinore. Të gjitha aspektet diskriminuese të trajtuara në libër janë sfida që e rëndojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri, e gjetiu.

Përkushtimi i Aurela Anastasi për temën që e ka trajtuar vërehet edhe në sugjerimet e saj ku mes tjerash jep rekomandime duke propozuar që të mirren në konsideratë skemat dhe praktikrat e vendeve që cilësohen si modele të mira për zbatimin e barazisë të cilat mund të shërbejnë për përmirësimin e metodave aktuale të Barazisë e Drejtësisë Gjinore në Shqipëri.

Parlamenti Evropian para 32 vjetësh i ndau Adem Demaçit Çmimin Saharov

Parlamenti Evropian më 4 dhjetor 1991 i ndau Çmimin Saharov, veprimtarit Adem Demaçi, duke e konsideruar si luftëtar të paepur për lirinë e mendimit dhe mbrojtës të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Duke e pranuar çmimin si homazh për popullin e Kosovës, Demaçi tha se "liria e fjalës është hapi i parë vendimtar drejt demokracisë. Pa lirinë e fjalës nuk ka dialog, pa dialog e vërteta nuk mund të vendoset dhe pa të vërtetën përparimi është i pamundur."

Këtë çmim deri më tash e kishin marrë: Saharovi, emrin e të cilit e mban, Dubček, Nelson Mandela, Marçenko, Aung Sun, disa nga të cilët (Mandela, Aung Su) u bënë më vonë edhe fitues të çmimit Nobel. Me këtë rast, në Parlamentin Evropian, Demaçi tha se "duke më nderuar mua, keni nderuar popullin tim të shumëvuar, por gjithmonë liridashës, paqedashës e krenar".

Çmimi Saharov për lirinë e mendimit, i pagëzuar sipas disidentit dhe shkencëtarit nga Bashkimi Sovjetik Andrej Saharov (Andrei Sakharov) është themeluar në dhjetor 1988 nga Parlamenti Evropian për të nderuar individët apo organizatat që i kanë kushtuar jetën e tyre mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Ai ndahet çdo

vit rreth datës 10 dhjetor, ditë në të cilën Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, që është e njohur edhe si Dita e të Drejtave të Njeriut. Më 1993, Klubi i Rektorëve Universitarë në Madrid i dha Çmimin Special për Paqe, kundër racizmit, ksenofobisë, për qëndrim paqësor e tolerant dhe për përpjekje për të ndërtuar një të ardhme të mbështetur në të drejtat e njeriut dhe në shumësi kulturore dhe kjo ndodhi pikërisht në kohën, kur qarqet serbe e akuzonin për luftënxitje.

Në shkurt 1994, pesë anëtarë të Parlamentit të Norvegjisë e kandiduan shkrimtarin Adem Demaçi për çmimin Nobel për letërsi. Në shtator 1994, u kandidua sërisht – tani për çmimin Nobel për Paqe, me ç'rast theksoi se "ky është një nder për mua dhe një mirënjohje për popullin shqiptar". Ndërkaq, më 14 dhjetor 1995 Adem Demaçi iu dorëzua Çmimi për të Drejtat e Njeriut i Universitetit të Oslos.

Demaçi, duke shprehur falënderimin për këtë çmim, tha: Këtë mirënjohje nuk e kuptoj vetëm si mirënjohje të punës dhe të luftës sime për të drejtat e popullit tim, por edhe si dëshirë të



qeverisë e të inteligjencës paqedashëse norvegjeze që t'i tërheqë vëmendjen opinionit të gjerë ndërkombëtar për problemin e Kosovës.

Adem Demaçi u lind në Prishtinë, më 26 shkurt të vitit 1936. Me prejardhje ishte nga fshati Lupq i Podujevës.

Është ndër emrat më të rëndësishëm në Kosovë të përpjekjeve paqësore për liri dhe për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës brenda ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ishte bërë i njohur qysh në fëmijëri si zë revoltues në

bankat e shkollës. Demaçi nuk hezitonte asnjëherë të dënonte padrejtësitë e shumta të regjimit serb.

Në vitin 1958 është dënuar me 5 vjet burg për shkak të shkrimeve dhe bindjeve të tij, politike e atdhetare. Në vitin 1963 ka themeluar në Prishtinë organizatën e quajtur "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", me program unik kombëtar të çlirimit dhe bashkimit të trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Kjo Lëvizje kishte arritur të zgjerohej në shumë qendra të Kosovës, por

edhe në trojet e tjera shqiptare nën pushtimin Jugosllav. Për shkak të vazhdimet të aktivitetit atdhetar, Adem Demaçi dënohet 15 vjet burg.

Edhe në vitin 1975 regjimi jugosllav e kishte dënuar 15 vjet burg. Demaçi ka mbajtur rreth 28 vjet, disa prej tyre në qeli i vetëm, gjatë kohës së regjimit të egër në RSFJ-së. Pas lirimit nga burgu në vitin 1990 Adem Demaçi udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut deri në vitin 1995.

Gjatë periudhës 1998-1999 ka qenë zëdhënës politik i UÇK-së, në zyren e tij, në Prishtinë.

Pas luftës u angazhua për respektimin e të drejtave të pakicave joshqiptare në Kosovë dhe për përmirësimin e gjendjes së tyre. Demaçi nga shqiptarët vlerësohej si simbol i rezistencës kombëtare. Në vitin 2010, ai u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës".

Demaçi ishte autor i disa librave: "Fërkime", "Gjarpitje e gjakut", "Libër për Vet Mohimin", "Heli e Mimoza", "Nëna Shegë e pesë gocat", "Shkrumbnajë e dashur", "Dashuria Kuantike e Filanit", "Alb Prometeu", "Politika", "Pushka" dhe "Tung vargu im". Demaçi ndërroi jetë më 26 korrik 2018.

RECENSION I LIBRIT ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSO MADHE (1856-2022)
(Botimi i dytë)

DISKURS DHE ANALIZË POLITIKE E GJEOPOLITIKE PËR FEDERATËN RUSE LIDHUR ME PUSHTIMIN E NJË PJESE TË UKRAINËS

LUFTA RUSO - UKRAINASE DHE AGRESIONI RUS KUNDËR UKRAINËS KA SHKAQE HISTORIKE,
POLITIKE, EKONOMIKE DHE USHTARAKE – GJEOPOLITIKE



Prof. dr. Eqrem ZENELAJ
(Kalorës i urdhrit të
Skënderbeut)

Më 24 shkurt 2022, Rusia filloi pushtimin në një shkallë të gjerë të Ukrainës, e që ky përshkallëzim filloi në vitin 2014, ku në vitin 2021, Putini kërcënoi zgjerimin e NATO-s drejt lindjes.

Ditë më përpara pushtimit, Rusia njohu zyrtarisht dy shtete të vetëshpallura brenda kufijve të Ukrainës: Republikën Popullore të Donetskut dhe Republikën Popullore të Luhanskut. Më 21 shkurt, Forcat e Armatosura Ruse hynë në rajonin e Donbasit në Ukrainën lindore. Më 22 shkurt, Këshilli i Federatës Ruse autorizoi njëzëri Putinin të përdorte forcën ushtarake jashtë Rosisë. Pra, më 24 shkurt, Putini njoftoi një "operacion special ushtarak" në Ukrainën lindore, që në fakt me këtë titull Putini tentoi ta fshehtë agresionin e hapur ndaj Ukrainës, duke e quajtur këtë operacion si: "Operacion special ushtarak".

Duke u prononcuar lidhur me luftën ruso - ukrainase, Papa Françesku deklaroi në një intervistë të faqes: "La Civiltà Cattolica", se: "Ne po përfjetojmë Luftën e Tretë Botërore"... dhe se është gabim të mendosh se është luftë vetëm mes Federatës Ruse dhe Ukrainës.

Prandaj, duke e parë interesimin e madh të lexuesit shqiptar, lidhur me librin tim me titull: "Çështja shqiptare përballë politikës dhe gjeopolitikës së Federatës Ruse", dhe aktualitetin e temës, që e kam trajtuar në këtë libër, lidhur me gjeopolitikën rusomadhe përballë Evropës Perëndimore dhe vendeve të Ballkanit, që nga viti 1856 e deri më sot, vendosa që ta riaktualizoj dhe ta ridimensionoj temën në fjalë, me një analizë të shkurtër dhe të veçantë. Lidhur me këtë gjeopolitikë aktuale të Federatës Ruse, ku kjo gjeopolitikë po dëshmohej sot si problem ruso-ukrainas, e që në fakt është një vazhdim i Luftës së Ftohtë: Lindje - Perëndim apo më mirë

të themi dëshmohej dhe riaktualizohet gjeopolitika ruse në Evropë, që nga viti 1856 me Traktatin e Parisit. Kjo gjeopolitikë e vitit 1856 e Rosisë Cariste, atëherë e sot ngel e njëjtë lidhur me pushtimin e Krimesë dhe Detin e Zi, si dhe daljen në ujërat e nxehta; dikur, si Rusi Cariste, pastaj si BRSS, e së fundmi si Federatë Ruse, si pika strategjike ushtarake në marrëdhëniet ndërkombëtare, e sidomos, që nga periudha e Luftës së Ftohtë e deri në ditët e sotme me agresionin rus ndaj Ukrainës.

Në krizën politike të ish-BRSS dhe dezintegrimin e saj, shumë shtete dolën të pavarura. Kjo nuk ishte dëshirë e Kremlinit zyrtar e as doktrinës së saj gjeopolitike, por si rezultat i garës në armatim, ku Rusia socialiste u varfërua dhe u detyrua të lirojë ca shtete të Bashkimit Sovjetik, që ta kenë pavarësinë e vet. Kjo ishte politikë e mençur e Gorbaçovit: Glasnost dhe Perestrojka me synimin, që një pjesë e republikave të fitojnë pavarësinë e Rusia të lirohet nga një barrë e rëndë ekonomike, që e kishte kapluar. Kjo ndodhi, jo pa pasoja, sepse Gorbaçovi u arrestua nga gjeneralët rusë, në krye me Jazovin, ku kjo, në fakt, ishte një puç ushtarak i politikës së vjetër dhe tendencave hegjemoniste, që BRSS të jetë superfuqi dhe të jetë përballë - Paktit NATO.

Pas dështimit të puçit ushtarak në ish - BRSS, në kohën e Gorbaçovit dhe dështimin e këtij puçi të gjeneralëve rusë, në krye me Jazovin, erdhi deri te shpërbërja e BRSS-së dhe deri te pavarësimi i disa shteteve të Rosisë e ndër to edhe pavarësia e Ukrainës.

Pas Boris Jelcinit ishte Vladimir Vladimiroviç Putin ai që e trashëgoi Jelcinit në krye të Federatës Ruse, ku ky menjëherë filloi agresivitetin ndaj republikave të pavarura.

Federata Ruse ishte pajtuar me pavarësimin e tyre, por me disa kushte, si vijon:

1. Shtetet e pavarura, si Ukraina nuk guxojnë të anëtarësohen në NATO, siç ndodhi me shtetet e ish- bllokut komunist: Bullgaria, Rumania, etj.

2. Këto shtete duhet që ta nënshkruajnë një deklaratë, sipas së cilës ato heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë, që të jenë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurisë, por këtë të

drejtë ia bartin Federatës Ruse. 3. Në një mënyrë apo tjetër ato duheshin të jenë lojale të Federatës Ruse (ashtu si është tani Bjellorusia, në krye me diktatorin, Llukashenko).

Rusia e Putinit, vazhdimisht, tentonte që në krye të Ukrainës të vinte kukulla të saj, që do të ndjekin vartësinë ndaj Moskës zyrtare dhe të jenë kukulla të Putinit.

Putini, një njeri i shërbimit sekret të ish-BRSS-së, që shërbeu edhe në Gjermaninë Lindore, ndërmoi një politikë të re dhe kërcënuese ndaj Perëndimit dhe se përpjekja e tij ishte që NATO-n ta mbajë sa më larg Rosisë. Gjithashtu, i kërcënonte edhe vendet e tjera

të dala nga BRSS-ja, që të mos anëtarësohen në Paktin NATO. Kjo tregon se Karta e OKB-së tanimë shkelet dhe nuk respektohet as nga vetë Rusia, sepse në Kartën e OKB-së, që njëherit është edhe si një lloj Kushtetute, janë shkëlur parimet themelore të saj, siç janë: Ndalimi i përdorimit të forcës, ndalimi i dhunës, kontributi për ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore dhe mosshkeljen e parimeve të Kartës së OKB-së.

Pra, bazuar në Kartën e OKB-së, Federate e sotme Ruse është antiligjore, si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit.

Karta e OKB-së nuk ka

ndryshuar dhe aty shënohet se anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit janë: BRSS, Kina, SHBA, Anglia, Franca, por jo Federata Ruse. Pra, kjo është një shkelje flagrante e Kartës së OKB-së, pasi që nuk është ndryshuar kjo Kartë dhe nuk ka ndonjë amendament shtesë. Ruajtja e paqes dhe e sigurisë nuk përfilllet nga ana e Federatës Ruse, si dhe nuk kontribuon për paqe në marrëdhëniet ndërkombëtare, por si nxitëse e luftës e paqes dhe sigurisë, si dhe rrezikim i paqes ndërkombëtare.

Putini duke u përgatitur kohë me parë për invazion ushtarak kundër Ukrainës, ai më në fund e sulmoi një shtet sovran e të



HAMZ LLADROVCI, AUTORI I LIBRIT "ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSO MADHE (1856-2022)"



Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Hamz (Smoji) Lladrovci u lind më 1969 në fshatin Gllanasellë të Drenasit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Drenas. Më pas u regjistrua në fakultetin e shkencave politike dhe administratë publike, ku merr thirrjen për studimet bachelor në shkencat politike dhe administratë publike. Pas mbarimit të fakultetit u regjistrua në studime master - drejtimi marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci. Këto studime i mbaroi me sukses shembullor, ku mori thirrjen shkencore të magjistratit (MAS). Hamz Lladrovci rrjedh nga një familje më tradita patriotike, e cila ka qenë e persekutuar dhe e ndjekur politikisht nga regjimi serbo-jugosllav. Kjo familje dha edhe dëshmorë të kombit. Hamz Lladrovci ka marrë pjesë në demonstrata të ndryshme, që u organizuan në Kosovë. Ndërsa, në demonstratat e janarit të vitit 1990 plagoset rëndë nga policia serbo-jugosllave, ku më pas transferohet për shërim jashtë vendit (Belgjikë). Ky transferim i shërbeu edhe për t'ikur persekutimeve nga pushtuesi. Ai u vendos në Belgjikë. Pas një periudhe kohore shërohet. Pas këtyre aktivitetëve atdhetare, Hamza, mbetet në Belgjikë, ku pastaj martohet dhe krijoi familjen e tij. Në Belgjikë punoi dhe jetoi për një dekadë. Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, si dhe pas dëbimit të okupatorit serb, Hamza kthehet për të jetuar dhe vepuruar në vendlindje - në Drenas. Hamz Lladrovci është shqiptar, ndërsa, ka shtetësinë belge. Jeton në Drenas me familjen e tij.

Botuesi



Çmimi 20€

ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE 1856-2022

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Botimi II-të

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci



ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE 1856-2022



Prishtinë 2023

pavarur dhe një popull të tij vëlla, që është sllav e që flasin gati të njëjtën gjuhë dhe kanë një traditë të përbashkët. Kjo tregon se deri më tani të gjitha luftërat, por edhe kjo e fundit në mes të Rusisë dhe të Ukrainës janë luftëra politike e ushtarake për interesa ekonomike e gjeopolitike. Duke menduar se Federata Ruse do ta pushtojë për pak ditë Ukrainën, Putini i bëri llogaritë gabim dhe nuk i doli ashtu.

Bashkësia Ndërkombëtare e dënoi këtë akt, këtë pushtim të Ukrainës, sepse ishte një aventurë, e cila o do të sjellë fundin e Putinit dhe të Federatës Ruse ose do të bëhet shkak për një Luftë të Tretë Botërore.

Aneksimi i Krimesë ishte hapi i parë i agresionit rus. Pastaj kryengritjet proruse në disa pjesë të Ukrainës Lindore të Donetskut e të Luhanskut, nuk i mjaftonin Putinit, sepse ai donte në Kiev të vinte një qeveri kukull, në mënyrë që kjo qeveri të jete anti NATO dhe satelitë i Putinit. Deri më tani janë vrarë me mijëra civilë, ushtarë dhe njerëz të pafajshëm. Granatohen qytete e fshatra, si dhe depo municioni e gjithçka. Me ndihmën e Perëndimit, Ukraina u armatos dhe po armatoset në vazhdimësi, kështu që bota demokratike u rreshtua me Kievin zyrtar dhe ky pushtim i një pjese të Ukrainës nga Federata Ruse u gjykua nga e mbare bota demokratike, por jo edhe nga satelitët e Putinit, siç janë: Bashar el Asad, Kim Il Sung II, nga vendet arabe, e sidomos nga Irani. Nga humbjet e mëdha, Putini kërcënon me luftë bërthamore, sepse humbi mijëra ushtarë, tanke e mjete të

tjera luftarake dhe më nuk i ka ngelur asgjë tjetër që mund t'i sjellë fitore, pos përdorimit të armëve nukleare bërthamore. Përdorimi i armëve bërthamore do të jetë fatal për njerëzimin, por do të sjellë edhe fatalitetin e vetë Federatës Ruse, ngase bota civilizuese, në krye me SHB-të do të përdorë, po ashtu, të gjitha mjetet konvencionale e jokonvencionale për ta thyer forcën ushtarake të Putinit. Pra, kjo luftë do të sillte Luftën e Tretë Botërore me pasoja të paparashikueshme.

Gjatë një adresimi, më 21 shtator, Putini njoftoi se do të mobilizojë deri në 300.000 rezervistë për të luftuar në Ukrainë. Ai, po ashtu, mbështeti planin për të aneksuar pjesë të Ukrainës, duke lënë të kuptohet se është i gatshëm të përdorë armë bërthamore për ta mbrojtur Rusinë. Mirëpo, gjatë këtij mobilizimi me mijëra ushtarë, që do të mobilizoheshin, ikën jashtë Federatës Ruse. Po ashtu, forcat demokratike në Rusi bënë demonstratë kundër politikës agresive të Putinit dhe kundër vazhdimit të luftës. Putini nuk përzgjedh aleatë, por çdo aleat i tij duhet të mbështetë këtë luftë të pakuptimtë, si: Llukashenko i Bjellorusisë, Kadirovi i Çeçenisë apo Irani i mullahëve, si dhe Koreja Veriore, që janë anti NATO e anti SHBA.

Pra, të gjithë këta aleatë të Putinit janë aleatë të panatyrshëm në shumë dimensione, si atë politik, ideologjik apo fetar. Putini nuk zgjedh mjete për politikën e tij destabilizuese e agresive. Po ashtu, Putini mban lidhje tradicionale dhe të ngushta edhe me presidentin e Serbisë -

Vuçiqin. Vuçiqi përdor Federatën Ruse për ta mbështetur në politikat agresive të tij ndaj Kosovës. Vuçiqi me partinë paramilitare: Lista Sërpska mban ndezur konfliktet dhe i përdor ato për destabilizimin e Kosovës. Ai synon politikën e vjetra të paraardhësve të tij për një Serbi të madhe dhe në këto rrethana bënë aleancë edhe me Kryeministrin e Shqipërisë, duke tentuar të krijojë një të ashtuquajtur: "Open Ballkan" - Ballkan të hapur, pasi Serbia, por edhe Shqipëria me kryeministër Edi Ramën, kanë dështuar në reforma politike e ekonomike, në luftimin e krimit të organizuar dhe shtetit ligjor dhe janë të penguar të integrohen në Unionin Evropian, pa këto reforma. Rruga e tyre është realizimi pikave të Berlinit, që kanë të bëjnë me integrimin e tyre në BE. Në këtë pikë bashkohen interesat e Rusisë, Vuçiqit dhe të Edi Ramës dhe mu për këtë arsye Serbia dhe Rusia tentojnë ta destabilizojnë politikën në Ballkan dhe përmes paramilitarëve të Lista Sërpskës tentojnë ta destabilizojnë situatën politike në Ballkan.

Vuçiqi ndjell politikën e paraardhësve të tij si të Dobrica Qosiqit, për copëtimin e Kosovës. E nxitur nga Kisha Ortodokse Serbe dhe e mbështetur nga Rusia e Putinit, Vuçiqi tenton ta destabilizojë Kosovën. Ai mban politika të dyfishta: në njërin anë tenton të futet në BE, kurse në anën tjetër nuk vë sanksione ekonomike ndaj Moskës zyrtare. Kjo, në një masë të madhe i ka irrituar edhe shtetet perëndimore, të cilat i dhanë së fundmi edhe një

ultimatum Vuçiqit për sanksione kundër Rusisë, ndryshe nuk do të ketë rrugë të anëtarësimit në BE, pa i vënë sanksione Moskës zyrtare dhe pa e nënshkruar një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Kosovën, ku do të figurojë edhe pika kryesore përfundimtare e njohjes reciproke në mes të Kosovës e të Serbisë.

Serbia nuk mund të anëtarësohet në Unionin Evropian pa një marrëveshje përfundimtare me Kosovën. Serbia luan me dy letra: në njërin anë kërkon të anëtarësohet në Unionin Evropian, ndërkaq në anën tjetër mban lidhjet tradicionale me Rusinë. Ky qëndrim dhe kjo lojë e lidhshipit aktual serb ka irrituar në masë kërret e Unionit Evropian, të cilët çdo ditë e humbin durimin dhe bëjnë presion dhe kusht, që Serbia të vërë sanksione ndaj Rusisë së Putinit.

Sulmi dhe okupimi i një pjese të Ukrainës nga Federata Ruse, ka pasoja të mëdha, sepse me këtë sulm dhe agresion ndaj një shteti të pavarur, tanimë, jo vetëm që rrezikohet rendi kushtetues botëror apo paqja dhe siguria ndërkombëtare, por është shkelur dhe atakuar edhe Karta e OKB-se, e cila është një lloj "Kushtetute" e Bashkësisë Ndërkombëtare mbi parimet e së cilës është ndërtuar rendi i ri botëror pas Luftës së Dytë Botërore, ku dispozitat e saj kanë mundësuar funksionimin e rendit politik e ushtarak botëror. Tanimë në këtë kohë me këtë agresion të Putinit ndaj një shteti sovran dhe anëtare e OKB-së, Evropa dhe bota kurrë nuk kanë qenë më të rrezikuara, qysh nga Lufta e Dytë Botërore.

Me pushtimin e një pjese të Ukrainës nga ana e Federatës Ruse, janë bërë edhe krime kundër paqes, krime kundër njerëzimit dhe vrasje masive në përmasa gjenocidi. Federata Ruse kurrë nuk ka qenë me e rrezikuar se sa sot nga shpërbërja e mëtejme e saj, si dhe shlyerja e saj përfundimisht si forcë apo superfuqi ushtarak e rendit juridik, politik e ushtarak botëror. Në rast të përdorimit të arsenalit nuklear nga ana e Putinit, kjo do të shkatërronte, jo vetëm Rusinë, por edhe një pjesë të madhe të njerëzimit. Putini në pamundësi të pushtimit blic të Ukrainës, ashtu si e mendoi, tani përdor edhe armë të ndaluara kundër popullatës civile e ushtarake. Në anën tjetër, ai lidh aleanca me shtetet islamike

(antiamerikane), si: Iranin, Sirinë, pastaj me shtetet diktatoriale: Korenë Veriore, Kinën dhe Serbinë. Putini synon të zgjerojë konfliktin edhe në Ballkan, në mbështetje të politikës agresive serbomadhe të lidhshipit të djeshëm dhe të Kosovës, si dhe të ushqejë ndjenja nacionaliste serbomadhe, që datojnë nga "Naçertanija" e Garashaninit (1845) e këndeje.

Kosova dhe shtetet ballkanike janë të shqetësuara nga ndikimi rus në Ballkan, si dhe nga financimet dhe agjenturat ruse në këto vende, duke mos përjashtuar Shqipërinë dhe Kosovën. Kosova është me fat që ka aleatë SHBA-të dhe shtetet më demokratike e më të fuqishme të botës.

Tani Serbia është e vetëdijshme se as me mbështetjen e Putinit e as me blerje të arsenalit ushtarak nga Rusia e Turqia, nuk mund të ndërhyjë në Kosovë, sepse me këtë agresion, Serbia do të bënte vetëvrasje politike, ushtarake e ekonomike, pasi Kosova është nën mbrojtje të KFOR-it (d.m.th. NATO-s), por edhe nuk është Kosova e djeshme, pa armë e pa organizim shtetëror e ushtarak. Sot, Kosova, ka Ministrinë e Mbrojtjes dhe ushtarë të stërvitur në SHBA dhe në Angli, por edhe armë, të cilat dje nuk i kishte, ku këto elemente janë garanci e mbrojtjes së Kosovës. Atë çka mund të bëjë Serbia, është nxitja dhe mbështetja e strukturave paralele për destabilizim të situatës politike të modelit rus, që Putini aplikoi në Krime, në Donesk e vendet rreth Rusisë, me banda e kriminelë të dirigjuar nga Moska zyrtare.

Nëse nuk ndalet lufta në Ukrainë, ashtu si ka tendencë Putini, që të involvohen edhe shtete të tjera në këtë luftë apo edhe përdorimi i armëve nukleare (ashtu si e shohim sot), atëherë kjo nënkupton edhe fillimin e ndonjë Luftë të Tretë Botërore dhe shkatërrimin e rendit të sotëm botëror.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova dhe Kroacia do të bashkëpunojnë për avancimin e volejbollit

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi, sekretari i përgjithshëm Besim Aliti, nënpresidenti Milaim Kelmendi si dhe krerët e Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), kryetari Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi, kanë pritur sekretarin e përgjithshëm të Komitetit Olimpik të Kroacisë (HOO),

Sinisha Krajaq dhe drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Kroacisë, Frane Zaniq dhe Roko Sikitiq. Palët kanë biseduar për thellim të bashkëpunimit mes institucioneve olimpike kombëtare dhe federatave kombëtare të të dyja shteteve si dhe në projekte të ndryshme. "Presidenti Krasniqi falënderoi mysafirët për vizitën, duke shprehur vullnetin dhe

gatishmërinë që bashkë me drejtuesit e FVK-së të punojnë për ngritjen dhe avancimin e volejbollit në vendin tonë. Nga ana e tyre mysafirët kroatë Krajaq dhe Zaniq premtuan bashkëpunim në projekte të ndryshme mes dy Komiteteve Olimpikë, por edhe mes dy Federatave të Volejbollit, bashkëpunimi i të cilave nuk ka munguar as në të kaluarën", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Kualifikohen Llapi dhe Malisheva

"Epoka e re"

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Llapi dhe Malisheva janë kualifikuar më tutje në garën e Kupës së Kosovës në futboll. Llapi e ka kaluar fazën e 1/16 të finales së Kupës pasi fitoi me rezultat bindës ndaj Phoenixit (4-1). Goli i parë në ndeshje u shënua në minutën e 29, derisa autor ishte mesfushori Hamdi Namani. Në pjesën e dytë vazhdoi festivali i golave. Gashijani realizoi për 2-0, derisa për golin e tretë u përkujdesi Arbnor Ramadani. Në listën e shënuesve për llapjanët u regjistrua edhe talenti Mërgim Cërnaverni.

Golin e vetëm për skuadrën nga Banja e Pejës e realizoi Miranaj. Ndërsa tutje u kualifikua skuadra e Malishevës që e mposhti Kikën me rezultat 3-2 në stadiumin "Liman Gegaj". Dhjetë ndeshje të tjera të fazës së 1/16 do të zhvillohen sot (e mërkurë), derisa njëra prej ndeshjeve më interesante pritet të zhvillohet në Skenderaj në mes të Drenicës dhe Ballkanit. Drenica këtë edicion po bën gara në Ligën e Parë, ndërsa Ballkani është kampion në fuqi dhe lider aktual në elitën e futbollit të Kosovës. Drita ka punë me Dardaninë, ndërsa Prishtina i shkon skuadrës së Rahovecit. Tri ndeshje të kësaj faze zhvillohen të enjten dhe një tjetër zhvillohet të premten.



PËRBALLJET E KUPËS

Llapi - Phoenix 4-1
Malisheva - Kika 3-2

Të mërkurë takohen:
Flamurtari - Dukagjini
Rahoveci - Prishtina
Fushë Kosova - 2 Korriku
Vilaznia (P) - Trepça '89
Ramiz Sadiku - Gjlani
Feronikeli 74 - Istogu
Dardania - Drita
Liria - Rilindja 1974
Vëllaznimi - Ferizaj
Drenica - Ballkani

Të enjten takohen:
Prishtinë e Re - Behari
Suhareka 23 - Trepça
Ulpiana - Vjosa

Të premten takohen:
Dinamo - Vushtrria

Daliq: Shqipëria është tepër e rrezikshme



ZAGREB, 5 DHJETOR - Zlatko Daliq është nga ata kroatë tipikë që askënd nuk e mendon më të mirë sesa veten, ndonëse pranon se shorti në "Euro 2024" ishte i tmerrshëm jo vetëm për shkak të Spanjës dhe Italisë, por edhe të kombëtares shqiptare. "Sipas mendimit tim, kemi grupin më të vështirë të mundshëm. Luajmë kundër kampionëve në fuqi të Evropës, kundër fituesve në fuqi të Ligës së Kombeve, ne jemi të tretët në botë, pra është grupi më i vështirë. Shqipëria, që luajti mirë në eliminatore, gjithashtu nuk është aspak kundërshtarë e lehtë. Më e keqja që mund të na ndodhte". Daliq ngacmohet që Shqipëria e kaloi grupin në

vend të parë, mbi Poloninë e Çekinë, ndryshe nga Kroacia. "Po, po, patjetër. Ata ishin të parët në grup, luajtën mirë dhe këtë nuk e priste askush. Realizuan një detyrë të shkëlqyer. I kemi në grup. Siç e thashë, grupi është shumë i vështirë. Kemi dy emra të mëdhenj, dhe Shqipërinë që është tepër, tepër e rrezikshme". Daliq ka kujtime nga Shqipëria, ndonëse që nga ajo kohë shumë gjëra kanë ndryshuar. Dikur trajner i Dinamos së Tiranës, dhe kandidat për stolin kuqezi, kroati do ta ketë kundërshtarë kombëtares shqiptare, madje në një skenë të madhe si Kampionati Evropian.

KB Prishtina sot përballet me KK Lovçen

PRISHTINË, 5 NËNTOR - KB Sigal Prishtina sot (e mërkurë) do të përballet me KK Lovçen, ndeshje kjo që luhet në kuadër të Ligës Ballkanike. Klubi më i madh në vendin tonë sërish

do të luajë në Ligën Ballkanike, të cilën prishtinasit e kishin fituar pak vite më parë. Sigal Prishtina, e cila synon t'i shkojë deri në fund kësaj gare, në duel me

Lovçen hyn me ambicie për fitore në mënyrë që ta bëjë hapin e parë në këtë garë joshëse. Dueli në mes të Sigal Prishtinës dhe Lovçen luhet në Pallatin e Rinisë dhe

Sporteve në Prishtinë, ndeshje që pritet të krijojë një atmosferë të zjarrtë nga tifozët prishtinas "Plisat". Sfida në mes të Sigal Prishtinës dhe Lovçen fillon në orën 17:30.



Bostoni eliminohet nga Kupa në NBA, befason Indiana

INDIANA, 5 DHJETOR - Çerekfinalët e Kupës në NBA rezervuan emocione dhe surpriza. Boston Celtics, që kryeson në Konferencën e Lindjes dhe një nga pretendentët kryesorë, humbi mundësinë për të luajtur për trofeun, pasi u mposht 122-112 nga Indiana Pacers. Tatum

me 32 pikë e Browni me 30 u përpoqën t'i japin fitoren Bostonit, por pa sukses. Për Indianën, 7 lojtarë realizuan mbi 12 pikë, ku u dallua Haliburtoni me një "triple double", 26 pikë, 10 rebounde dhe 13 asiste. Pacersi do të ndeshet në finale me fituesin e çiftit Milwaukee Bucks -

New York Knicks, nga do të dalë edhe finalisti në Lindje. Ndërsa në Perëndim fitoi skuadra e New Orleansit, që mundi 127-117 Sacramento Kingsin, ndeshje e dominuar nga miqtë. Të gjithë titullarët e Pelicansit realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Ingrami, autor i 30 pikëve. Sabonisi realizoi

një "triple double" për vendasit, me 26 pikë, 13 rebounde dhe 10 asiste, por që mbetën për statistikë. Pelicansi do të ndeshet në finale me fituesin e çiftit Phoenix Suns - Los Angeles Lakers për ta përcaktuar duelin final në Konferencën e Perëndimit.



Duka për mediet italiane: Të gjithë shqiptarët duan të jenë në Gjermani

TI RANË, 5 DHJETOR - "Ethet" e shortit vijojnë të jenë të forta, për më tepër për një përfaqësues si Shqipëria, që shkon në këtë Evropian me statusin e një ekipi jo favorit, shanset janë të vogla, por dëshira për të bërë mrekullitë është shumë e madhe.

Armand Duka, kreu i FShF-së, mbetet i pranishëm në mediet italiane, pasi interesimi është edhe më i madh tani që kuqezinjët u shortuan në një grup me Italinë, pikërisht një nga rivalët që Duka nuk e dëshironte. "Në të vërtetë nuk donim të luanim, pasi kemi raporte shumë të mira jo vetëm politike, por edhe në futboll. E dimë se do të luajmë kundër kampionëve të Evropës, e dimë forcën e Italisë, të futbollistëve, të skuadrës italiane. Por edhe neve nuk ka dhuruar askush asgjë. Kemi fituar grupin, duke bërë më të mirën e mundshme për të mbërritur në ndeshje të tilla", ka thënë Duka.

Në intervistën e tij për mediet italiane, Duka u pyet edhe në lidhje me tifozët, me politikanët që do të dëshironin të ishin në stadium, për interesimin e madh që paraqet kjo sfidë në Shqipëri: "Problemi ynë tani është që të gjithë shqiptarët duan të jenë në stadium. Nga momenti që kanë parë shortin, të gjithë duan të jenë në Dortmund



për ta ndjekur ndeshjen Itali - Shqipëri. Shpresojmë që me tifozët të krijojmë një atmosferë pozitive, si ajo e miqësorës në Xhenova. Kryeministri shqiptar e sigurt që do të vijë. Nuk mendoj se do të mungojë ndonjë politikan në ndeshjen kundër Italisë, të gjithë do të vijnë. Kryeministri Rama është tifoz futbollit, tifoz i Kombëtares dhe sigurisht do të jetë në stadium në këtë ndeshje. Meloni, nuk e di. Shpresoj të vijë". Pavarësisht emrit të madh që përfaqëson Italia, Shqipëria nuk zbrit e dorëzuar në fushë më 15 qershor, në sfidën e parë në "Euro 2024" "Të mundesh Italinë është diçka shumë e vështirë, shumë e vështirë, por ne do ta provojmë ta bëjmë. Do ta luajmë si një ndeshje normale. Po luajtëm pa presion, do

të jetë më e lehtë për ne. Italia është një skuadër me përvojë, me lojtarë të mirë. Janë kampionë në fuqi të Evropës, por vuajtën pak në kualifikuese", ka shtuar Duka. Në fund nuk mungoi as një parashikim për fituesin e këtij Evropiani, për favoritët: "Evropianin e fiton Shqipëria (qesh). Nëse ndodh, e gjithë Shqipëria do të vijë në Gjermani për ta parë finalen. Tani të flasim seriozisht, skuadrat më të forta janë ato të vazos së parë, Anglia, Franca, Portugalia. Gjithsesi në turne të tillë ka specifika të ndryshme dhe kurrë nuk dihet çfarë mund të ndodhë. Mund ta fitojë edhe Italia siç bëri në vitin 2021. Për mua favoritët janë Franca, Anglia dhe Italia", ka deklaruar Duka.

Një vit larg tenisit, Nadali: Nuk pres shumë nga ky rikthim

MALLORCA, 5 DHJETOR - Rafael Nadal konfirmoi para pak ditëve se do të rikthehet të garojë pas thujse një viti jashtë kompeticioneve të tenisit. Spanjollit do të marrë pjesë në turneun e Brisbane në Australi që nis më 31 dhjetor. Por, së fundmi tenisti nga Mallorca ka edhe një lajmërim tjetër për fansat. Njëpër njëpër rrjetet sociale, Nadal theksoi se duhet të mësojë veten, por edhe fansat e tij se tashmë pretendimet nuk mund të jenë të njëjtat si vite më parë. 37-vjeçari u shpreh se do ta gjejë veten në një terren të paeksploruar më parë dhe për këtë duhet të mësohet edhe ai vetë. "Kam pasur shumë frikë të lajmëroja rreth rikthimit tim pasi, siç dihet, është mbushur thujse një vit nga hera e fundit që kam luajtur tenis. I jam nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale, edhe pse nuk është kjo ajo që më tremb. Çfarë më frikëson më shumë është



se do ta gjej veten në një terren të panjohur dhe e vërteta është se më duhet të mësohen se nuk duhet të pres shumë nga ky rikthim. Është diçka e re për mua me të cilën duhet të mësohem, pasi gjatë gjithë karrierës kam qenë shumë kërkues nga vetja. Tani jam në një moment tjetër, në një situatë tjetër.

Kam qenë kërkues në maksimum nga vetja dhe tani do të jetë e vështirë sepse më duhet të pranoj një tjetër realitet. Duhet t'i fal vetes edhe disa gabime në momentin e parë që do të rikthehem, sepse me shumë mundësi do ta kem të pamundur të mos gaboj", u shpreh Nadal.

SHKURT

Union Berlini interesohet për Bardhin

Union Berlini ka shprehur interesim për Enis Bardhin, i cili në janar mund të largohet nga Trabzonspor. Trajneri i ri i Union Berlinit, Nenad Bjelica, ka punuar me Bardhin në klubin turk dhe tash ka shprehur dëshirën që sërish ta ketë nën urdhrat e tij. 28-vjeçari në të kaluarën ka luajtur edhe për Levanten, Ujpestin dhe Prespa Birluk. Ndërsa për Maqedoninë e Veriut ka luajtur 59 ndeshje dhe ka shënuar 16 gola.

Adana Demirspori shkarkon Kluivertin

Adana Demirspori e ka shkarkuar Patrick Kluivertin nga detyra e trajnerit. Humbja e fundit ndaj Samsunsporit (2-3) vulosi fatin e trajnerit holandez, i cili ka fituar vetëm një nga gjashtë ndeshjet e fundit. Në detyrë që prej muajit korrik, ish-drejtori i futbollit të PSG-së pati përvojën e tij të parë në stolin e një klubi në Turqi. "Me marrëveshje të dyanshme u ndamë nga trajneri ynë Patrick Kluivert. Dëshirojmë ta falënderojmë zotin Kluivert dhe stafin e tij për atë që i kanë sjellë klubit tonë dhe t'i urojmë suksese në karrierën e tij të ardhshme", thuhet në njoftimin e Adanas.

Roma nuk e shkarkon Mourinhon

Jose Mourinho rrezikonte shkarkimin përpara disa javësh nga Roma, me klubin që nuk dukej i kënaqur nga rezultatet e fundit. Por fitoret e njëpasnjëshme dhe futja në garë për një vend në Ligën e Kampionëve duket se kanë bërë që verdhekuqtë të ndryshojnë mendje. Në Itali janë të sigurt se Roma do t'ia besojë stolin 60-vjeçarit deri në fund të sezonit, atëherë kur përfundon kontrata e tij. Më pas do të shihet vazhdimësia në rezultate dhe dëshira e portugezit nëse do të vazhdojë me kryeqytetasit ose jo, edhe pse kjo gjë duket pak e vështirë të ndodhë.

Presidenti i Bayernit për Mullerin: Ikonë absolute e këtij klubi

Prej 16 sezonesh pjesë e kampionëve gjermanë të Bayern Munchenit, mund të thuhet me plot gojë se "veterani" gjerman i sulmit, Thomas Muller, është një "legjendë e gjallë" e këtij klubi, i cili ende arrin të dhurojë spektakël në fushën e blertë. Presidenti i Bayernit, Herbert Hainer, është i bindur se Thomas Muller do ta rinovojë kontratën e tij, që skadon në vitin 2024, me "numrin 1" të "bavarezëve" që foli për tabloidet gjermane, duke konfirmuar rëndësinë e kontributit të 34-vjeçarit. "Muller është një ikonë absolute për Bayernin dhe një lojtar me merita të mëdha këtu. Të gjithë do të donim që ai ta mbyllte karrierën në Munchen. Jemi në negociatë. Jam optimist dhe shpresoj që ai të qëndrojë me ne", ka deklaruar Hainer.

Leao: Besojmë në titull

Ylli i AC Milanit, Rafael Leao, ka folur edhe për titullin në Serinë A. Ai ka thënë se kampionati është i gjatë dhe se besojnë në "Scudetto". Portugezi u mungon kuqezinjve prej 11 nëntorit, kur pësoi një tërheqje muskulore në transfertën me Leccen. "Ndihehem mirë. Nuk është një dëmtim serioz, por nuk duhet të rrezikoj. Po punoj bashkë me mjekët për ta shmangur rrezikun, pasi kampionati është i gjatë. Unë ndihem mirë. Nuk ndiej dhembje. Po përpiqem të rikthehem në formën time 100 % për t'i ndihmuar shokët e skuadrës. Shpresoj të rikthehem sa më shpejt. Për momentin ka shumë presion, por unë e them gjithmonë që presioni është pozitiv. Ky Milan është shumë i fortë. Unë gjithmonë tentoj të krijoj një atmosferë të mirë në skuadër, edhe t'i ndihmoj shokët. Sidomos të rinjtë. Titulli? Po, besojmë. Kampionati është shumë i gjatë", ka thënë Leao.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, e duke u bazuar në vendimin me nr. 499/23 të datës 05.12.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 05.12.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

II. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 8

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;

- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 05.12.2023 deri me datë 19.12.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Qovanaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Adnan Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

Nezir Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Valton Jakupi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Riza Pepa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Mixha" Gjakovë.

Arbnore Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "2 Dëshmorët" Sheremetaj K.K Gjakovë.

Agim Matarona nga Podujeva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë drejtimi Gjeodezi.

Ismet Osmani nga Morina, komuna e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknikë "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, drejtimi Gjeodezi.

Erbolina Cenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Zekirja Rexha" Gjakovë.

Shukrije Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lavdim Ibrahim shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, i na osnovu odluke br. 199/23 od godine 05.12.2023 Izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh. A, dana 05.12.2023, objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Fizičko obezbeđenje

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Srednja škola i Osnovna škola.

Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci

Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;

Koeficijent plate: 3.9

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, možetakođe je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;
- Prednost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL "Përparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);

II. Naslov: Čistač kancelarija i objekata

Broj izvršilaca: 8

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Izveštava: Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata

Koeficijent plate: 3.9.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od pretpostavljenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte;

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Pëparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada

16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 05.12.2023 do 19.12.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Pëparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Automekanik – 3 pozita

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: Udhëheqësi i mirëmbajtjes së makinave

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Kryen punët e servisimit dhe riparimit të të gjitha llojeve të automjeteve;
- Teston dhe kontrollon rregullsinë për mbajtje në gjendje të rregullt pune të automjeteve;
- Teston dhe provon rregullsinë e motorit, ndërruesit, boshtit rrotullues alternatorit, fyejve, përquesit, lyerjen e motorit, pastrimin e filtrave;
- Kryen dhe punë të tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathësitë e kërkuar: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diploma e shkollës së mesme;
- Një (1) vit përvojë pune;

Konkursi është publikuar më datë 6 dhjetor 2023 dhe mbyllet më datë 20 dhjetor 2023.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Kopja e diplomës të shkollës së mesme;
3. Çertifikata e lindjes;
4. Vërtetim që nuk jeni në hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A u kuranu, ovo je poruka:

KONKURS

Naslov pozicije: Automekanik – 3 pozicije

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

Naslov supervizora: Izveštaj: Voda održavanja automobila

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje zakazane obaveze: neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti : (kratak opis glavnih zadataka)

- Vršiti servisiranje i popravku svih vrsta vozila;
- Testirajte i kontrolišite regularnost održavanja vozila u redovnom radnom stanju;
- Testira i testira regularnost motora, prekidače, rotacione sekire alternatora, uvrede, reflektore, farbu motora, čišćenje filtera;
- Izvršavanje drugih zadataka u skladu sa redosledom direktnog lenjira.

Potrebne su veštine : (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Saradničke, međuljudske veštine i timski rad;

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Diploma srednje škole;
- Jedna (1) godina radnog iskustva;

Konkurs je objavljen 6. decembar 2023 godine, a zatvoren je 20 decembar 2023 godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Kopija ID-a;
2. Kopija diplome srednje škole;
3. Izvod iz matične knjige rođenih;
4. Dokaz da niste u istrazi.

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Čišćenje" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Тел: +383 (0) 38 603 191

